

United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



Nations Unies Mission d'Administration
Intérimaire des Nations Unies
au Kosovo

PROVIZIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT
I SEANCËS KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 4
DHE 9 JANAR 2008

SA KONSTITUTIVNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
4. i 9. JANUARA 2008. GODINE

JANAR – JANUAR

2008

RENDI I DITËS

1. Formimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitet;
2. Dhënia e Betimit të deputetëve;
3. Zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryetarit të Kuvendit.

DNEVNI RED

4. Formiranjë Komisijë za mandatno- imunitetna pitanja;
5. Polaganjje zakletve poslanika;
6. Izbor Predsedništava i predsednika Skupštine.

AGENDA

1. Forming Committee for Mandates and Immunities;
2. Oath of the Deputies;
3. Election of the Presidency and the President of the Assembly.

T R A N S K R I P T
I SEANCËS KONSTITUIVE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË 4
DHE 9 JANAR 2008

Seanca filloi punën në orën 14,00.

Seancën e kryesoi deputeti më i vjetër Akademik Mark Krasniqi, kurse bashkëkryesuese ishte deputetja më e re Njomëza Emini.

KRYESUESI MARK KRASNIQI: Të nderuar të pranishëm,
Kam nderin dhe kënaqësinë që, në pajtim me Rregulloren e Punës të Kuvendit të Kosovës, unë – Mark Krasniqi, në cilësinë e deputetit më të vjetër për nga mosha, i legjislaturës së tretë, ta kryesoj Seancën inauguruese të Kuvendit të Kosovës, të dalë nga zgjedhjet e lira dhe demokratike, të mbajtura më 17 nëntor 2007.

Në drejtimin e seancës do të më ndihmojë deputetja më e re për nga mosha, Njomëza Emini.

Me këtë rast, më lejoni që në fillim t’ju dëshiroj mirëseardhje dhe punë të mbarë të gjithë deputetëve të legjislaturës së re.

Njëkohësisht, kam kënaqësi të veçantë që t’i përshëndes dhe t’ju dëshiroj mirëseardhje mysafirëve të nderuar:

- Presidentit të Kosovës, zotit Fatmir Sejdiu,
- Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, zotit Joachim Ruecker,
- Komandantit të KFOR-it, Gjeneral Javier de Marnhac,
- Përfaqësuesit të Bashkimit Evropian, Fleger Burton,
- Përfaqësuesve të zyrave diplomatike të Kosovës,
- Shefes së Zyrës Amerikane, zonjës Tina Kajdanov,
- Përfaqësuesve të bashkësive fetare në Kosovë,
- Të gjithë të ftuarve të pranishëm në këtë Seancë inauguruese, si dhe përfaqësuesve të mediave.

Të nderuar deputetë, më lejoni që para se t’ia jap fjalën e rastit Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Ruecker, t’ju njoftoj se pika e tretë e rendit të ditës shtyhet për të mërkurën, më 9 janar 2008 në orën 10,00.

Tani propozoj të fillojmë të procedojmë me pikën e parë të rendit të ditës.
Pika e parë e rendit të ditës është:

- **Formimi i Komisionit për Mandate dhe Imunitete**

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se në bazë të Rregullës 3.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, partitë dhe koalicionet e partive parlamentare, duhet të propozojnë nga një deputet në Komisionin për Mandate dhe Imunitete.

Ky komision duhet të bëjë shikimin e dokumentacionit përkatës të zgjedhjeve të mbajtura më 17 nëntor 2007, përkatësisht Rekomandimin e Komisionit Qendror Zgjedhor, si dhe dokumentacionin mbi certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve nga ana e Përfaqësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në bazë të listës së Komisionit Qendror Zgjedhor.

Andaj, ftoj përfaqësuesit e partive dhe të koalicioneve, ose shefat e grupeve parlamentare që të propozojnë emrat e deputetëve për anëtarë të këtij komisioni.

Unë do t'i lexoj emrat e partive me radhë dhe ju, ose shefat, ose përfaqësuesit e partive a të koalicioneve, i propozoni emrat e tyre. Do t'i lexoj shkurtesat, sepse emrat janë shumë të gjatë.

Përfaqësuesi i PDK-së:

FATMIR LIMAJ: Partia Demokratike e Kosovës për anëtar të Komisionit propozon prof. Dr. Arsim Bajramin.

KRYESUESI: Përfaqësuesi i LDK-së:

NEKIBE KELMENDI: Për Komisionin për Mandate dhe Imunitete, Lidhja Demokratike e Kosovës propozon zotin Lutfi Haziri.

KRYESUESI: Faleminderit! AKR:

IBRAHIM MAKOLLI: Aleanca Kosova e Re, për anëtar të Komisionit për Mandate dhe Imunitete propozon zonjushën Suzana Novobërdaliu.

KRYESUESI: Koalicioni LDD-PSHDK:

LULZIM ZENELI: Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, për anëtar të Komisionit propozon zonjën Besa Gaxheri.

KRYESUESI: Faleminderit! AAK:

ARDIAN GJINI: Faleminderit! Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, për anëtar të këtij komisioni propozon deputetin Ibrahim Selmanaj.

KRYESUESI: Faleminderit! KDTP:

MAHIR YAGCILAR: Së pari, urime të gjithëve! Ne jemi Grupi 7+, i cili përbëhet nga KDTP, Vakrat dhe PREBK dhe për Komision propozojmë Shpresa Muratin. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! VAKAT propozoi anëtarin e përbashkët. Le të urdhërojë PDAK:

SABIT RRAHMANI: Partia Demokratike e Ashkalinjve të Kosovës, për anëtar të Komisionit për Mandate dhe Imunitete propozon zotin Hetem Arifi.

KRYESUESI: Faleminderit! SDSKiM:

U ime Srpske Demokratske Stranke i Narodne Stranke predlaže se Vladimir Todorović.

KRYESUESI: Faleminderit! SLS:

SLOBODAN PETROVIĆ: Dobar dan! Pre svega želim da čestitam svim novim poslanicima mandat i pozdravljam uvažene goste. Ono što želim da kažem je da Samostalna Liberalna Stranka ima svoj Poslanički klub u Parlamentu Kosova. Poslanički klub Samostalne liberalne stranke čine još tri stranke: Nova demokratija, Savez socijalno-nezavisnih demkrata i Gradjanske inicijative Goranaca. Naš kandidat je Ljubiša Živić. Hvala!

KRYESUESI: Faleminderit! SDA:

NUMAN BALIĆ: Inače, mi ovo SDA izgovaramo kao SD, a ne SDA. Dakle, predlažemo u ime naše stranke Veziru Emruš za člana Komisije. Hvala ljepa!

KRYESUESI: Faleminderit! IRDK:

XHEVDET NEZIRAJ: Faleminderit, zoti kryesues! Urime të gjithë deputetëve për mandatin e ri. Pasi që unë jam i vetëm nga IRDK, s’do ta propozoj veten, por pasi jam në Grup me Aleancën për Ardhmërinë e Kosovës, atëherë le të na përfaqësojë deputeti që e propozoi Ardian Gjini. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit! PREBK, është propozuar nga koalicioni. Faleminderit. Shkojmë me radhë. Tash është SKMS. Qenka propozuar. Tash shkojmë me numrin 17 SNS, 18 SNSDKiM. Faleminderit të gjithëve!

Lus deputetët që me ngritje dore të deklarohen për miratimin e emërimit të Komisionit përkatës.

Kush është “për”?

A ka kush “kundër”? Nuk ka.

Abstenim? Nuk ka.

Konstatohet se Kuvendi njëzëri miratoi propozimin për emërimin e Komisionit për Mandate dhe Imunitete.

Ftoj Komisionin, domethënë këta anëtarë, që të takohen menjëherë në sallën numër 10 dhe pastaj Kuvendit t'i paraqesin raportin. Lus Komisionin që mundësisht të mos zgjasin lidhur me këtë më tepër se 10 minuta.

(Ndërprerje e shkurtër)

KRYESUESI: Lus deputetët të ulen në vendin e vet. Tash kemi kënaqësinë që të ftojmë Përfaqësuesin e Sekretarit Gjeneral të Kombeve të Bashkuara, zotin Joachim Ruecker që të mbajë fjalën e rastit. Urdhëroni, zoti Ruecker!

JOACHIM RUECKER:

Zoti Kryetar, i nderuar kryesues, deputetë të nderuar të Kuvendit, zonja dhe zotërinj, mysafirë të nderuar,
Uvaženi poslanici, dame i gospodo, poštovani gosti,

It is an honor and a pleasure to meet with you, to be present at this the third inaugural session of the Assembly of Kosovo and I congratulate you on your election to this house. You will be following in the footsteps of the highly successful Assembly which oversaw significant developments within Kosovo's Institutions and with regard to the Status process. I would like to use this opportunity to express my gratitude to the previous Assembly including its President and the members of its Presidency. Kosovo's institutions have indeed reached a high degree of maturity and I would like to elaborate on this a bit more but I understand that this is a short meeting which will be adjourned after a few formal steps you have taken your oath and this will be continued next week when you will elect the Assembly Presidency and when as I understand a new Government will also be presented and voted upon. Allow me, and I've done this in agreement with the President to say if my substantial remarks until next week when we meet again. Thank you for inviting me today and I wish you all a very successful term in office. Thank you.

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Ruecker! Tani duhet ta presim Komisionin për Mandate dhe Imunitete që të na paraqesë raportin e vet lidhur me verifikimin e mandateve të deputetëve të zgjedhur të këtij legjislacioni.

(Pauzë e shkurtër)

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,
Ftoj kryesuesin e Komisionit për Mandate dhe Imunitete, zotëri Arsim Bajramin, që të paraqesë raportin e Komisionit.

ARSIM BAJRAMI: I nderuar Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, i nderuari President i Kosovës, i nderuari kandidat për Kryeministër të Kosovës, i nderuari kryesues i Seancës dhe e nderuara bashkëkryesuese e seancës, të nderuar kolegë,

Në emër të Komisionit për Mandate dhe Imunitete, do të paraqes raportin për verifikimin e mandateve.

Komisioni për mandate dhe imunitete i Kuvendit të Kosovës, i themeluar në seancën e sotme, më 4 janar 2008, në përputhje me mandatin e tij, Kuvendit i paraqet këtë

R A P O R T

Në mbështetje të Rregullës 3.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit, Komisioni për Mandate dhe Imunitete, në mbledhjen e mbajtur më 4 janar 2008, shikoi dokumentacionin përkatës zgjedhor, si vijon:

- Rekomandimin e Komisionit Qendror Zgjedhor për certifikimin e rezultateve zgjedhore për Kuvendin e Kosovës;
- Vërtetimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm për certifikimin e rezultateve të zgjedhjeve për Kuvendin e Kosovës, të mbajtura më 17 nëntor 2007;
- Listën e deputetëve të regjistruar në Kuvendin e Kosovës.

Komisioni, në bazë të shqyrtimit të dokumentacionit të cekur më lartë, konstatoi sa vijon:

1. Në legjislaturën e tretë të Kuvendit të Kosovës janë certifikuar 120 deputetë nga partitë politike, koalicionet, iniciativat qytetare dhe kandidatët e pavarur, që kanë marrë pjesë në zgjedhjet e 17 nëntorit të vitit 2007, si vijon:

- Partia Demokratike e Kosovës, 37 deputetë;
- Lidhja Demokratike e Kosovës 25 deputetë;
- Aleanca Kosova e Re 13 deputetë;
- Koalicioni Lidhja Demokratike e Dardanisë – Partia Shqiptare Demokristiane 11 deputetë;
- Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës 10 deputetë;
- Subjekti SDSKiM 3 deputetë;
- Subjekti SLS 3 deputetë;
- Koalicioni VAKAT 3 deputetë;
- Subjekti KDTP 3 deputetë;
- Subjekti PDAK 3 deputetë;
- Subjekti SDA 2 deputetë;
- Subjekti PREBK 1 deputet;
- Subjekti SNSDKiM 1 deputet;
- Subjekti IRDK 1 deputet;
- Subjekti SNS 1 deputet;
- Subjekti politik SKMS 1 deputet; dhe
- Subjekti politik GIG 1 deputet.

Komisioni ka konstatuar se në seancën e sotme janë të pranishëm 112 deputetë, andaj seancës plenare i propozohet të bëjë verifikimin e mandateve dhe të vazhdojë punimet sipas agjendës së paraparë dhe rregullave të procedurës. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit!

Të nderuar deputetë, ju ftoj që me një votim formal të përkrahim këtë raport të Komisionit që e dëgjuam tash.

Faleminderit!

A ka kush “kundër”?

Abstenim? Shenjë e mirë kjo për bashkëpunim të mëtejshëm. Mirë shumë!

Faleminderit shumë!

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- Betimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës

Tekstin e betimit e ka secili deputet para veti në gjuhën të cilën e flet, në gjuhën amtare.

Ju njoftoj se betimi solemn i deputetëve është një veprim i paraparë në Rregullën 3.3 të Rregullores së Punës të Kuvendit.

Për të përmbushur këtë akt solemn, lus deputetët që të ngritën në këmbë, të dëgjojnë tekstin që do ta lexoj unë, dhe vetëm në fund – të gjithë së bashku, shqiptojmë fjalën: **B e t o h e m i!** Secili në gjuhën e vet, kuptohet.

(Para dhënies së betimit, deputetja Melihate Tërnkolli kërkoi që në tekstin e betimit të futej edhe çështja e pavarësisë së Kosovës, por kryesuesi Mark Krasniqi tha se kjo çështje nuk është sot në rend dite dhe se pavarësinë e Kosovës do ta kemi shumë shpejt).

Teksti i betimit është ky:

“Unë, deputet i Kuvendit të Kosovës, i zgjedhur me votën e lirë, sot solemnisht betohem se me ndershmëri e sinqeritet, me përkushtim dhe devotshmëri, me tërë qenien time, me të gjitha aftësitë e mia do të punoj në interes të Kosovës dhe të të gjithë qytetarëve, do të angazhohem në mbrojtjen dhe respektimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë, në mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të integritetit institucional të Kosovës, në garantimin e lirive dhe të drejtave të njeriut në pajtim me ligjet e vendit dhe me standardet evropiane”.

DEPUTETËT: **B e t o h e m i!**

(Duartrokitje)

KRYESUESI: Faleminderit! Lus deputetët që personalisht të nënshkruajnë tekstin e deklaratës së betimit, e cila pastaj i dorëzohet Sekretarisë së Kuvendit në fund të seancës.

Përsëris edhe një herë, sepse ndoshta nuk keni dëgjuar të gjithë. Ju lus që secili ta nënshkruaj personalisht deklaratën që e dëgjuam dhe t'ia dorëzojë Sekretarisë së Kuvendit. Ju faleminderit!

Të nderuar deputetë, me kaq përmbyll seancën e sotme plenare, duke iu dëshiruar deputetëve punë të mbarë në ushtrimin e funksionit të tyre. Mirë u pafshim të mërkurën, më 9 janar 2008, në orën 10,00 në këtë sallë, për të vazhduar me pikën e tretë të rendit të ditës. Faleminderit!

Më 9 janar 2008

Vazhdimi i seancës konstitutive të Kuvendit të Kosovës.

Seanca filloi punën në orën 12,00.

Seancën e kryesoi deputeti më i vjetër akademik Mark Krasniqi, kurse bashkëkryesuese ishte deputetja më e re Njomëza Emini.

KRYESUESI MARK KRASNIQI: Në sallë janë të pranishëm 102 deputetë, prandaj mund t'ia fillojmë punës.

Të nderuar deputetë dhe mysafirë të pranishëm,
Mirë se keni ardhur në vazhdimin e seancën konstitutive të Kuvendit të Kosovës, të filluar më 4. janar 2008.

Ju njoftoj se edhe sot, deri në zgjedhjen e Kryesisë dhe të Kryetarit të Kuvendit, unë do ta drejtoj këtë seancë bashkë me deputeten më të re të legjislaturës së tretë, Njomëza Emini.

Para se të fillojmë me procedim, më lejoni të konstatoj se në seancë tani janë të pranishëm 112 deputetë, kështu që Kuvendi mund t'i vazhdojë punimet. Pra, vazhdojmë me procedimin sipas rendit të ditës.

Numri i deputetëve të pranishëm në sallë tani është 117.

Rendi i ditës

Zgjedhja e Kryesisë dhe e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

Të nderuar deputetë,

Në bazë të Kreut 9.1.7 të Kornizës Kushtetuese, të Rregullës 4 të Rregullores së Punës, si dhe të rezultateve të zgjedhjeve të 17 nëntorit 2007, i ftoj partitë parlamentare dhe koalicionet që t'i propozojnë emrat e kandidatëve për anëtarë të Kryesisë së Kuvendit. Para së gjithash do t'ju informoj se cilat parti janë ato që do t'i kenë përfaqësuesit e vet në Kryesinë e Kuvendit

- LDK-ja 2 anëtarë, PDK-ja - 2 anëtarë, njeri prej të cilëve duhet të deklarohet për kryetar të Kuvendit, do të thotë - 2 anëtarë, njëri kryetar i Kuvendit, LDK-ja - 2

anëtarë, AKR-ja - 1 anëtar, Koalicioni LDD – PSHDK - 1 anëtar, partitë ose koalicionet që përfaqësojnë komunitetin serb në Kosovë - 1 anëtar, sipas marrëveshjes në mes tyre, dhe partitë ose koalicioni që i përfaqëson komunitetet joshqiptare dhe joserbe në Kosovë - 1 anëtar, sipas marrëveshjes ndërmjet tyre.

I ftoj përfaqësuesit e partive me rend, që të dalin këtu dhe të propozojnë emrin e kandidatit të vet.

Në sallë tani janë 119 deputetë.

RAMË BUJA: Zoti kryesues, përshëndetje për ju dhe për Kryesinë e punës, Përshëndetje për ju z. Ruecker, Zoti Kryetar, Zoti Kryeministër, dhe ju kolegë të nderuar deputetë, Urimet më të mira për punë të mbarë dhe të suksesshme, punë të përbashkët dhe ju mysafirë tjerë që jeni prezentë.

Partia Demokratike e Kosovës, gjegjësisht Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, për anëtar të Kryesisë propozon Jakup Krasniqin dhe Xhavit Halitin, ndërsa për Kryetar të Kuvendit të Kosovës, propozon zotin Jakup Krasniqi. Është rendi që të thuhet dy fjalë për biografinë e zotit Krasniqi, dhe unë po i them këtu.

Zoti Jakup Krasniqi është i lindur më 1 janar 1951 në Negroc të Drenasit, është magjistër i historisë me profesion, është veprimtar i dalluar politik, ish i burgosur politik, ish zëdhënës i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, pjesëmarrës i Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje, ministër në Qeverinë e përkohshme, ministër në legjislaturën e parë të Kuvendit të Kosovës, deputet në dy legjislaturat e mëparshme dhe në këtë të tretën, ish shef i grupit parlamentar në mandatin e kaluar, autor i disa librave dhe i publikimeve të ndryshme. Tani propozohet nga Grupi parlamentar për kryetar të Kuvendit dhe besoj ky Kuvend e ka nderin që ta ketë kryetar të vetin zotin Jakup Krasniqi. Urime!

KRYESUES MARK KRASNIQI: Ju faleminderit! Nga LDK-ja 2 anëtarë. Urdhëroni!

NEKIBE KELMENDI: I nderuari kryesues, e nderuara bashkëkryesuese, Të nderuar kolegë deputetë, Mysafirë të nderuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës i propozon Kuvendit të Kosovës që për anëtarë të Kryesisë të jenë: dr. akademik Sabri Hamiti dhe Eqrem Kryeziu, ndërkaq e informon Kuvendin e Kosovës, përkatësisht Kryesinë e ardhshme se shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës do të jetë zoti Eqrem Kryeziu, ndërkaq zëvendës i shefit të grupit parlamentar zoti Lutfi Haziri.

KRYESUESI MARK KRASNIQI : Ju faleminderit! AKR-ja - 1 anëtar. Urdhëroni!

IBRAHIM MAKOLLI : I nderuari kryesues,
Të nderuar kolegë,
Të nderuar mysafirë,

Aleanca Kosova e Re për anëtar të Kryesisë në Parlamentin e Kosovës propozon prof. dr. Ibrahim Gashin.

KRYESUESI – Ju faleminderit! Nga LDD-ja dhe PSHDK-ja – 1 anëtar.

LULZIM ZENELI: I nderuari zoti kryesues,
Të nderuar deputetë,
Mysafirë të respektuar,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë për anëtar të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës propozon akademik Nexhat Dacin, kurse ju njoftojmë se shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë është mr. Lulzim Zeneli. Ju faleminderit!

KRYESUESI MARK KRANIQI- Ju faleminderit! Nga komuniteti serb – 1 anëtar

SLAVIŠA PETKOVIĆ: Ja sam ovde obavestio, i pošto smo dve grupe, nismo uspeli da postignemo dogovor za danas, znači nemamo saglasnost svih 10 poslanika i danas nećemo predložiti kandidata za člana Predsedništva.

KRYESUESI MARK KRANIQI- Ju faleminderit! Nga komuniteti joshqiptarë dhe joserbë - 1 anëtar.
Izvolite – Urdhëroni!

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani predsedavajući, poštovane dame i gospodo poslanici,

U ime Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke želim da istaknem da Samostalna liberalna stranka koja ima svoj Poslanički klub sa 6 poslanika, u kojoj je 5 poslanaika srpske zajednice, imamo kandidata za člana Predsedništva Skupštine Kosova. On je gospodin Slobodan Petrović, inače šef koalicije Samostalne liberalne stranke, diplomirani pravnik, otac jednog deteta, čovek radan, vredan, svojim rezultatima mislim da je sam sebe nametnuo za poziciju na kojoj je kandidovan. Hvala!

KRYESUESI MARK KRANIQI- Ju faleminderit!

Do të thotë, deri në marrëveshjen në mes tyre, nga komuniteti serb zgjedhja e anëtarit të Kryesisë bëhet në mbledhjen tjetër të Kuvendit.

Kalojmë në këtë të fundit, nga komuniteti joshqiptarë dhe joserb – 1 anëtar.

MAHIR YAGCILAR: E propozojmë për anëtar të Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, zotin Xhezair Muratin nga partia Vakati. Mirëpo, anëtari i Kryesisë nga subjektet politike: Vakati, KDTP dhe PREBK, që tash i kemi tash 7 deputetë në Kuvendin e

Kosovës, do të ndërrohet me rotacion. Kështu që propozimi është kështu, tash për tash. Për sot unë jam ende shef i grupit parlamentar, por për seancën tjetër do të vendosim edhe për shefin e grupit parlamentar. Ju faleminderit!

KRYESUESI MARK KRANIQI: Ju faleminderit! Sabit Rrahmani, urdhëroni!

SABIT RRAHMANI: I nderuari zoti kryesues,
Zoti Kryetar,
Zoti Ruecker,
Zoti Kryeministër,
Të nderuar deputetë,

Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës numëron 3 deputetë në Kuvendin e Kosovës dhe jemi të barabartë për nga numri i deputetëve me komunitetin turk dhe me komunitetin boshnjak.

Korniza Kushtetuese nuk e ka ndarë komunitetin rom, ashkali dhe egjiptas, por këtyre komuniteteve ua ka garantuar 4 vende në Kuvendin e Kosovës, kurse ne si ashkali i kemi 3 vende, egjiptasit e kanë 1 vend dhe romët 1 vend.

Ne kemi kërkuar, por nuk kemi arritur marrëveshje me koalicionin 7+, që në rotacion të hyjë edhe komuniteti i ashkalive dhe kemi kërkuar që në rotacionin e parë ta kemi vendin e parë si anëtar i Kryesisë, duke marrë parasysh që të gjitha minoritetet, në dy legjislacionet e kaluara, komuniteti boshnjak, komuniteti turk, komuniteti egjiptas dhe komuniteti rom, kanë pasur anëtarë në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës. I vetmi është komuniteti i ashkalive që deri më tash nuk ka pasur anëtar në Kryesinë e Kosovës. Ne kërkojmë nga Kuvendi dhe nga Kryesia e Kuvendit që të ndërhyjë në këtë marrëveshje tonë, sepse nuk kemi mund të kemi rezultat dhe të konsultohemi për më tutje se cili do të jetë anëtari i Kryesisë nga pakicat. Ju faleminderit!

KRYESUESI MARK KRANIQI- Ju faleminderit!

Nga koalicioni joshqiptarë dhe joserbë ende nuk ka marrëveshje për anëtar të Kryesisë, por kur ta bëjnë marrëveshjen, atëherë do të votohet në një mbledhje tjetër.

NUMAN BALIQ: Ju faleminderit, zoti kryesues!

Poštovanje i selam svima koji su prisutni,

Vrlo kratko da kažem u vezi sa izborom člana Predsedništva. Kao što znate, Ustavni okvir jasno govori oko toga da se jedan član Predsedništva iz redova drugih zajednica bira na osnovu konsultacija i dogovora predstavnika ovih zajednica.

Želim da vas obavjestim da niko nije razgovarao, ne samo sa Aškalijama nego ni sa SDA-om. Inače, SDA, odnosno dio bošnjaka koji mi predstavljamo imamo dva poslanika u Parlamentu Kosova. Nisu obavljene konsultacije, dakle preporučujem, bilo bih pošteno da se razgovara sa nama, u najmanju ruku zaslužujemo da se razgovara sa nama, i da u okviru tih rotacionih ciklusa, s obzirom da su mogućnost članstva u Presedništvu u svim prethodnim mandatima, u svim prethodnim vladama, nekoliko puta

iskoristili i KDTP i VAKAT, a takodje i Egipčani, i mislim da treba ovaj put da bude kandidat iz redova SDA. Naravno, podržavam ovo što je gospodin Sabit Rrahmani rekao u vezi sa ovim. Dakle, SDA ima kandidaturu i traži dogovor, pošten dogovor oko imenovanja člana Predsedništva iz drugih zajednica. Havala vam ljepo!

KRYESUESI MARK KRANIQI- Ju faleminderit!

Pra, Koalicioni joshqiptar dhe joserbë, kur ta arrijnë marrëveshjen mes tyre, atëherë propozohet kandidati dhe votohet.

Të nderuar deputetë,

Pasi që kemi marrë emrat e deputetëve për anëtarë të Kryesisë së Kuvendit dhe për Kryetarin e Kuvendit, i ftoj deputetët që me një votim formal me ngritjen e dorës, pa debat, të deklarohen për zgjedhjen e tyre.

Kërkoj nga Shërbimi i deputetëve që të konstatojë edhe njëherë numrin e deputetëve të pranishëm në seancë, si dhe të përgatitet për numërimin e votave. Në sallë nuk ka ndryshuar numri i deputetëve, pra në sallë i kemi 119 deputetë.

Lus deputetët që të deklarohen për propozimet e bëra, përveç nga Koalicioni joshqiptar dhe joserbë, sepse siç thamë, do të votohet më vonë, kur të merren vesh ata mes veti. Do të thotë, për këto propozime që u dhanë, votohet.

Kush është “për”?

Ju faleminderit!

Ju informoj se 88 deputetë janë “për”.

Kush është “kundër” le ta ngrejë dorën. Shërbimi i numëron votat.

Një (1) “kundër”.

Kush abstenon?

Askush!

Në bazë të rezultatit të votimit, konstatoj se me 88 vota “për”, 1 “kundër” dhe pa asnjë abstenim, anëtarë të Kryesisë së Kuvendit u zgjodhën:

- Nga PDK-ja Jakup Krasniqi, i cili njëherësh u zgjodh Kryetar i Kuvendit të Kosovës, dhe Xhavit Haliti, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.
- Nga LDK-ja u zgjodhën Sabri Hamiti dhe Eqrem Kryeziu.
- Nga AKR-ja Ibrahim Gashi.
- Nga LDD-ja dhe PSHDK-ja akademik Nexhat Daci.
- Komuniteti serbë dhe Koalicioni joshqiptarë dhe joserbë, kur të merren vesh, i votojmë edhe kandidatët e tyre.

Kryesisë dhe Kryetarit të Kuvendit i dëshiroj sukses dhe punë të mbarë në emrin tim dhe në emrin tuaj.

(duartrokitje)

Ftoj Kryetarin e Kuvendit, zotin Jakup Krasniqi, që ta zë vendin e vet dhe të vazhdojë udhëheqjen e kësaj seance. Urdhëroni, zoti Kryetar!

(duartrokitje)

KRYETARI JAKUP KRASNIQI: Ftoj anëtarin e Kryesisë, zotin Eqrem Kryeziu, që të më shoqërojë në vazhdimin e seancës.

(duartrokitje)

I nderuari kryesues,
I nderuari Kryetar Sejdiu,
I nderuari mandatar i Qeverisë, Thaçi,
I nderuari përfaqësues i Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Ruecker,
Zonja ambasadore Tina Kajdanov,
I nderuari përfaqësues i Bashkimit Evropian, zoti Jonsson,
Zonja e zotërinj deputetë e deputete,
Qytetarë të nderuar,

Ndjehem i nderuar që sot po e marr një detyrë kaq me përgjegjësi dhe të nderuar që të udhëheq Kuvendin e Kosovës, andaj më lejoni që sinqerisht t'ju falënderoj të gjithë juve për besimin e dhënë.

I falënderoj qytetarët e Kosovës për besimin e dhënë në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007 dhe për mbështetjen e dhënë gjatë gjithë jetës dhe aktivitetit tim dhe i siguroj të gjithë qytetarët e Kosovës se angazhimi im do të vazhdojë të jetë në shërbim të tyre dhe të interesit të vendit, për sot dhe nesër.

Në mënyrë të veçantë nga zemra dua t'i përshtëndes të gjitha familjet që atdheut i dhuruan më të dashurit e tyre, e posaçërisht Jasharët legjendarë.

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Angazhimi im do të jetë në shërbim të institucionit që e përfaqësojmë, në shërbim të institucionalizimit, të zhvillimit e të avancimit të demokracisë. Kemi për obligim që të vihem në mbrojtje të vlerave të kulturës e të traditës kombëtare, të vlerave të shoqërisë dhe të demokracisë evro-perëndimore në kërkim të së cilës ishin brezat e tërë të Kosovës. Mbrojtja e kushtetutshmërisë, e ligjeve dhe e Rregullores së Punës së Kuvendit do të jenë në nivel më të lartë të kodit të mirësjelljes parlamentare.

Në punën time në udhëheqjen e Kuvendit të Kosovës do ta respektoj fjalën, të drejtën e secilit nga ju. Duke u respektuar ju, ne e respektojmë të drejtën e qytetarëve dhe votën e tyre të shenjtë që e keni marrë secili nga ju. Në punën e Kuvendit deputetët nuk do t'i ndaj në deputetë të pozitës dhe të opozitës. Duke respektuar të drejtën e lirë dhe liritë e

qytetarëve, angazhimin e tyre për liri dhe demokraci, unë vazhdoj t'i respektoj të drejtat e komuniteteve joshumicë që jetojnë në Kosovë dhe do të garantoj respektimin e barabartë të tyre edhe në punën e Kuvendit të Kosovës.

Kontributin e komunitetit ndërkombëtar për ndihmën humanitare, për rindërtimin e vendit, për ndërtimin e institucioneve demokratike, për paqen dhe sigurinë që e kanë vendosur në Kosovë, për jetën e lirë, për perspektivën që ia kanë kthyer vendit dhe popullit të Kosovës pa dallime etnike, do ta ruaj dhe thelloj bashkëpunimin me të gjitha institucionet e Bashkimit Evropian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, përkatësisht me OSBE-në dhe NDI-në si mbështetës të Parlamentit.

Jam i vetëdijshëm për vështirësitë e mëdha që i kemi përpara e të cilat duhet t'i zgjedhim së bashku edhe me institucionet ndërkombëtare të instaluar në Kosovë. Jam i bindur se kemi nevojë për besim e mirëkuptim të gjerë, jo vetëm në mes nesh që do të jemi në këtë parlament.

Në vitin e parë të kësaj legjislature do të ndodhë zyrtarizmi i vullnetit të qytetarëve të Kosovës për shtetin e pavarur dhe sovran në koordinim me vendet e demokracisë verio-atlantike të cilat po e mbështesin fuqishëm të drejtën tonë për mëvetësi.

Ne, me punën dhe angazhimin tonë të përditshëm, me përgjegjësi e përkushtim do të tregojmë dhe garantojmë se e meritojmë këtë mbështetje. Edhe njëherë ju falënderoj për besimin e dhënë. Ju ftoj për bashkëpunim dhe shpreh gatishmërinë për punë serioze, të sinqertë në shërbim të të gjithë qytetarëve të vendit tonë. Ju faleminderit!

(duartrokitje)

EQREM KRYEZIU: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

KRYETARI: Të nderuar deputetë dhe mysafirë të pranishëm, para se të fillojmë me procedim të mëtejshëm, më lejoni të konstatoj se në seancë janë të pranishëm 119 deputetë, nga 120 sa i ka Kuvendi i Kosovës, kështu që janë të gjitha kushtet për të proceduar me rendin e ditës në vazhdim.

Në rend të ditës kemi:

1. Zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës,
2. Zgjedhjen e Kryeministrit dhe të Qeverisë së Kosovës,

Pastaj do të vazhdojmë me betimin e Qeverisë.

Lus deputetët që ta ngrehin dorën për miratimin e rendit të ditës.

Kush është “kundër”?

A ka abstenime?

Konstatoj se me 85 vota “për”, 6 “kundër” dhe 3 abstenime, u miratua rendi i ditës.

Deputetë të nderuar, vazhdojmë punën me pikën e parë të rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është:

- Zgjedhja e Kryetarit të Kosovës

Në pajtim me Kreun 9, pika 2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe të Rregullës 14.2 të Rregullores së Punës të Kuvendit, ftoj përfaqësuesit e Koalicionit Qeverisës, të partive që kanë të drejtë të propozojnë kandidatë për kryetar të Kosovës, pra të Partisë Demokratike dhe të Lidhjes Demokratike të propozojnë emrin e kandidatit për Kryetar të Kosovës.

Ndërkohë, Kryetari i Kosovës, zoti Fatmir Sejdiu, ka paraqitur kërkesën për dorëheqje. Dorëheqja i është pranuar dhe kërkojmë në bazë të Rregullores, që Lidhja Demokratike në koalicion me Partinë Demokratike ta propozojnë kandidatin e tyre. Para se të bëjmë propozimin, lus zotin Ruecker që ta marrë fjalën.

JOACHIM RUECKER: Zoti Kryetar,
I nderuari kryesues,
Deputetë të nderuar të Kuvendit,
Zonja dhe zotërinj,
Mysafirë të nderuar,
Ashtë nderë të jem me ju sot.

Uvaženi poslanici,
Dame i gospodo,
Poštovani gosti,
Za mene je velika čast da budem sa vama danas.
It is an honor and a pleasure for me to be with you at this very important session of the new Kosovo Assembly which was inaugurated last week.

I congratulate all of you on your election to this house. In particular I would like to congratulate you Mr. Jakup Krasniqi and all the members of the Presidency on your elections which we just witnessed. All of you here will be following in the footsteps of the highly successful Assembly which oversaw significant development within Kosovo's institutions and in the Status process.

Now I would like to use this opportunity to express my gratitude to the previous Assembly to its President Kole Berisha and to the members of the presidency. Kosovo's institutions have reached high degree of maturity.

In this context I would also like to thank the Central Election Commission and the OSCE. It is no coincidence that the international observers stated that the November election which for the first time saw Kosovo Assembly, Municipal and mayoral Elections all held at the same time were in line with European and international standards.

I would also like to thank the political parties for running their campaigns concurrently with the Status negotiations without diminishing their contribution to either. I would

particularly like to acknowledge their firm appearance to the agreement to campaign in a tolerant and in an ethical manner.

The Ahtisary process is behind us with the plan on the table and the negotiations on Kosovo Status let by the Troyka are over. NATO has expressed its intent to stay engaged in Kosovo. The EU expressed its readiness to set up European security and defense policy mission and to contribute to an international civilian office here. The Un Security Council has discussed Kosovo as recently as 19th of December. There is brought agreement that UNMIK has achieved what is achievable under the present circumstances and that the Status Quos is untenable. There is also brought agreement that Kosovo's political Status needs to be resolved as soon as possible. But there is also brought agreement that the next steps require continue closed coordination with international community; they require very high degree of responsibility. I am very confident that this Assembly and the people of Kosovo will act accordingly.

Today I also want to warmly welcome the formation of a new board based Government including representatives from minority communities to be presented and voted upon in the next agenda item and I take this opportunity to congratulate the outgoing Government and Prime Minister Agim Ceku for their dedicated and successful work which has brought Kosovo forward.

Ladies and Gentlemen it is not exaggerated to say that today the world is watching you. International attention is focused in Kosovo and following today's formal endorsement of the Presidency of the Assembly and the upcoming election of the President and of the new Government I am confident that all institutions will be fully functional not only with regard to Status process. There are serious economic and social challenges affecting the daily lives of Kosovo citizens which need to be addressed. The people of Kosovo will also look to the institutions to you to lead the fight against corruption and to strengthen the rule of law and the people of Kosovo as well as international community will look to the Assembly and Government when it comes to a set of new laws that will also further improve the right and the rights of minority communities. For a number of reasons Kosovo Serb participation in the past elections was regrettably low but there is plenty of room for active participation in the Government, in the Assembly and in its Committees. I am confident that this Assembly and the emerging Government will embrace the contribution offered by the representatives from all of Kosovo's communities. The greatest challenge of us all will be to ensure that the political decisions do not undermine peace and stability in Kosovo and beyond. As members of the highest party of the Provisional Institutions of Self-Government you have a very important responsibility not only to your voters but also to Kosovo as a whole with regard to get in the next right. In this context I would like to assure you that UNMIK and the international community stand ready to support you. Thank you for inviting me to speak and I wish you a successful term in office

KRYETARI: E falënderoj zotin Ruecker për fjalën e tij. Tani ne radhë është kandidatura për kryetar të Kosovës. Ftoj anëtarin e Kryesisë, zotin Eqrem Kryeziu, që ta paraqesë kandidaturën.

EQREM KRYEZIU: I nderuari Kryetar i Parlamentit të Kosovës,
Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,
Mysafirë të lartë dhe të respektuar,

Kam nderin dhe kënaqësinë që në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës dhe të partnerëve të koalicionit, sot të paraqes para jush kandidaturën për Kryetar të Kosovës, e ky është zotëri Fatmir Sejdiu.

Më lejoni, siç e kërkon protokollin dhe rasti solemn, të lexoj shkurtimisht të dhëna për zotëri Fatmir Sejdiun.

Fatmir Sejdiu u lind më 23 tetor 1951 në Pakashticë, komuna e Podujevës, Kosovë.

Shkollimin fillor dhe të mesëm e ka mbaruar në Podujevë, ka mbaruar Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Prishtinës, në vitin 1974, ku i ka mbaruar edhe studimet pasuniversitare, si dhe ka mbrojtur disertacionin e doktoratës.

Është profesor ordinar në Universitetin e Prishtinës. Për studime të thelluara ka qëndruar në Francë - Universiteti Paris 2, në vitin 1984, në Seksionin e Historisë, të institucioneve të ekonomisë, të filozofisë dhe të sociologjisë të së drejtës, dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës – Arizona Stejt University për 4 muaj, si dhe ka pasur qëndrime më të shkurtra studimore në universitetet tjera. Ka publikuar shumë punime shkencore nga fusha juridike, historike dhe juridike-kushtetuese si dhe libra të veçanta nga këto fusha.

Fatmir Sejdiu ka qenë pjesëmarrës i Kuvendit themelues të Lidhjes Demokratike të Kosovës më 23 dhjetor 1989. Në Kuvendin e Parë Zgjedhor në vitin 1991 është zgjedhur anëtar i Këshillit të Përgjithshëm dhe më 1992 anëtar i Kryesisë së LDK-së, ndërsa në vitin 1994 Sekretar i Përgjithshëm i saj.

Në vitin 2004 është zgjedhur sërish Sekretar i Përgjithshëm i Lidhjes Demokratike të Kosovës, ndërsa në vitin 2006 është zgjedhur Kryetar i Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Ka qenë anëtar i Komisionit Qendror për organizimin e Referendumit për pavarësinë e Kosovës, të mbajtur më 1991. Është zgjedhur deputet në Kuvendin e Republikës së Kosovës më 1992 dhe më 1998. Po kështu, më 1998 është zgjedhur Sekretar i Përgjithshëm i Kuvendit edhe Kryetar i Komisionit për Çështje Kushtetuese.

Në vitin 2001, në zgjedhjet e para demokratike të pasluftës, është zgjedhur deputet i Kuvendit të Kosovës dhe anëtar i Kryesisë së Kuvendit, në të cilat cilësi është rizgjedhur në vitin 2004. Gjatë këtij mandati po ashtu ishte anëtar i Komisionit për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Integritet Evro-atlantike.

Më 10 shkurt 2006 është zgjedhur President i Kosovës, detyrë të cilën e kryen edhe tani, deri pak më parë.

Gjatë kësaj periudhe me sukses e ka kryer këtë funksion, duke drejtuar njëkohësisht edhe delegacionin e Kosovës në bisedimet për statusin politik të Kosovës, përkatësisht pavarësimin e vendit.

Komunikon në frëngjisht dhe anglisht. Është i martuar dhe ka tre fëmijë. Jeton në Prishtinë.

Ju faleminderit për vëmendje!

(duartrokitje)

KRYETARI: Ne kemi një kërkesë me 25 nënshkrime për një kandidatë të dytë, por në ekran nuk është paraqitur askush për ta paraqitur kandidaturën.

Urdhëro, Ahmet Isufi!

AHMET ISUFI: Të nderuar deputetë,

Të nderuar mysafirë,

Duke konsideruar procesin demokratik që po zhvillohet në Kosovë, ne si Aleancë për Ardhmërinë e Kosovës kemi kandidatin të cilin e propozojmë për President të Kosovës, duke u bazuar edhe në Rregulloren e Kuvendit, Rregulla 16.2. Të gjitha procedurat janë kryer me kohë, prandaj i propozojmë Kuvendit zotëri Naim Malokun për President të Kosovës.

Naim Maloku u lind në fshatin Llabjan të Pejës, më 17.02.1958. Pas shkollimit fillor dhe atij të mesëm në vendlindje, pranohet dhe vazhdon studimet në Akademinë Ushtarake-Teknike të Zagrebit në vitin 1976.

Në vitin 1981 diplomohet nga Akademia me gradën toger dhe inxhinier i diplomuar i kimisë.

Në vitin 1985, si oficer i lartë burgoset për arsye politike dhe dënohet në Gjykatën Ushtarake të Sarajevës me 4.5 vjet burg. Pas vuajtjes së dënimit është themelues dhe kryetar i shoqatës së njohur "Migjeni" në Lubjanë të Sllovenisë. Pjesëmarrës aktiv i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që nga marsi i vitit 1998. Prej fillimit është nënkryetar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës dhe deputet në Kuvendin e Kosovës, tani në mandatin e tretë.

Në mandatin e kaluar, anëtar i Kryesisë së Kuvendit dhe kryetar i Komisionit për Siguri.

Duke llogaritur vlerat që ka si njeri, si intelektual, si politikan i shquar, ne besojmë se delegatët e Kuvendit të Kosovës do të votojnë zotëri Naim Malokun për Kryetar të Kosovës. Ju faleminderit!

(duartrokitje)

KRYETARI: Njoftoj deputetët se në pajtim me Kreun 9.2.8 të Kornizës Kushtetuese dhe Rregullën 14.2 të Rregullores së Punës së Kuvendit, zgjedhja për Kryetar të Kosovës do të bëhet me votim të fshehtë. Në dy votimet e para kërkohen dy të tretat e deputetëve të Kuvendit, dhe nëse nuk zgjedhet në votimin e parë dhe të dytë, për votimin e tretë kërkohen 61 vota të deputetëve.

Me qëllim të procedimit me votim të fshehtë për zgjidhjen e Kryetarit të Kosovës, Administrata e Kuvendit i ka bërë përgatitjet administrative dhe teknike, duke siguruar:

- Komisionin votues prej 3 zyrtarëve të Departamentit ligjor, nën monitorimin e plotë, dhe nga një deputet të grupeve parlamentare, Regjistrin e deputetëve të pranishëm për votim, fletëvotimet, kutitë e votimit dhe vendvotimin.

Para se t'i ftoj grupet parlamentare dhe subjektet politike që të caktojnë nga një deputetë për të vëzhguar dhe monitoruar procesin e votimit, fjalën e ka kërkuar kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, i nominuari për Kryeministër, zoti Thaçi. Zoti Thaçi, e keni fjalën!

HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar, përshëndetje të gjithëve. Unë kam kënaqësinë që në dy vitet fundit kam punuar bashkë me Presidentin Sejdiu, si anëtar i Ekipit të Unitetit. Sot jemi edhe partner të koalicionit, prandaj Partia Demokratike e Kosovës i jep mbështetje të plotë kandidaturës së zotit Sejdiu për President të ardhshëm të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI: Nga mjetet e informimit publik, pra nga gazetarët, kërkoj që të na mirëkuptojnë dhe të na e lëshojnë sallën sepse duhet bërë përgatitjet për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës. Ju falënderoj për mirëkuptim!

Derisa Administrata e përgatit votimin, ftoj kryetarët e grupeve parlamentare dhe të koalicioneve që t'i paraqesin kandidatët e tyre për ta monitoruar procesin e votimit.

Nga PDK-ja, zotin Ramë Buja.

RAMË BUJA: Propozoj për këtë Komision zotin Gani Koci.

Nga Lidhja Demokratike, zotin Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Subjekti ynë e propozon zotin Ramë Manaj për anëtar të Komisionit mbikëqyrës.

Nga AKR-ja, zotin Ibrahim Makolli.

IBRAHIM MAKOLLI: propozojmë zotin Arsim Rexhepi.

Nga Lidhja Demokratike e Dardanisë, zotin Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Nga Lidhja Demokratike e Dardanisë propozojmë Naser Rugovën.

Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, zotin Adrian Gjini.

ARDIAN GJINI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës e propozojmë zonjën Donika Kada Bujupi për këtë komision.

Nga 7+, zotin Mahir Yagcilar.

MAHIR YAGCILAR: Ju faleminderit, zoti Kryetar! Edhe njëherë ju dëshirojmë suksese në punë. Komisiona Enis Kenervan veriyorus.

Nga SNS-ja. SNS-ja a ka kandidat të vetin?

Fjalën e ka kërkuar Riza Smakaj. E ke fjalën, i nderuar.

RIZA SMAKAJ: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës, Kuvend i nderuar,

Ju lutem, me qëllimet më të mira, në funksion të ligjshmërisë, unë angazhohem që të bëhet interpretimi dhe aplikimi autentik i dispozitës së nenit 9.2.8 c: Kryetarin e Kosovës e zgjedh Kuvendi i Kosovës. Kuvendi i Kosovës, natyrisht, logjikisht, ju lutem, e pranon dorëheqjen, bie fjala. Prandaj, angazhohem që ta pranojë dorëheqjen Kuvendi i Kosovës, në mënyrë që të mos kemi asnjë pengesë juridike. Ju falënderohem!

KRYETARI: Ne e lexuam që Kryetari e ka paraqitur kërkesën për dorëheqje dhe i është pranuar dorëheqja.

Ftoj zyrtarët e Kuvendit dhe anëtarët e grupeve parlamentare që t'i zënë vendet e tyre.

Gjylnaze Syla e ka kërkuar fjalën. Urdhëro, zonja Gjylnaze!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar. Me qëllim që të ndihmoj dhe të qartësoj punën e Kuvendit, unë dëshiroj të thirrrem në Rregullën 9.2.9 të Kornizës Kushtetuese, e cila thotë se mandati i Kryetarit të Kosovës pushon me dorëheqjen e tij. Me këtë desha t'ju ndihmoj juve, zoti Kryetar. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Atëherë, fillojmë me procesin e votimit.

Adem Grabovci, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Agim Veliu, Ahmet Isufi, Ali Lajçi, Alush Gashi, Anita Morina, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Arsim Bajrami, Arsim Rexhepi, Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Behgjet Pacolli, Berat Luzha, Berim Ramosaj, Besa Gaxherri, Bojan Stojanović, Branislav Grbić, Bujar Bukoshi, Donika Kadaj, Dragiša Mirić, Drita Kadriu, Drita Maliqi, Driton Tali, Džezair Murati, Edita Tahiri, Elheme Hetemi, Emursh Xhemajli, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Eqrem Kryeziu, Esat Brajshori, Eten Arifi, Et'hem Çeku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmire Berisha, Fehmi Mujota, Flora Brovina, Gani Buçinca, Gani Geci, Gani Koci, Gjylnaze Syla, Hafize Hajdini, Hajdin Abazi, Hajredin Hyseni, Hajredin Kuçi, Haki Shatri, Hashim Thaçi, Heset Cakolli, Hydajet Hyseni – Kaloshi, Ibrahim Gashi, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmanaj, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Kaqusha Jashari, Kolë Berisha, Kosara Nikolić, Ljubiša Živić, Luljeta Shehu, Lulzim Zeneli, Lutfi Haziri, Mahir Yagcilar, Mark

Krasniqi, Melihate Tërmkolli, Memli Krasniqi, Mihailo Šćepanović, Mimoza Ahmetaj, Mursel Haljilji, Müfera Şınık, Myrvete Pantina, Myzejene Selmani, Naim Maloku, Naim Rustemi, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Nexhat Daci, Numan Balić, Nurishahe Hulaj, Njomza Emini, Qamile Morina, Radmila Vujović, Ramadan Avdiu, Ramadan Gashi, Ramë Buja, Ramë Manaj, Rasim Selmanaj, Rita Hajzeraj, Riza Smaka, Rrustem Mustafa, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Sadik Idrizi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sanije Aliaj, Selvie Halimi, Skënder Hyseni, Slaviša Petković, Slobodan Petrović, Suzan Novobrdaliu, Synavere Rysha, Shkumbim Demaliaj, Špresa Murati, Teuta Hadri, Vezira Emruš, Vladimir Todorović, Vlora Çitaku, Xhavit Haliti, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Zef Morina, dhe të fundit, Zylfi Merxha, Zylfije Hundozi.

Le të bëhen gati deputetët që do ta monitorojnë numërimin: Gani Koci, Ramë Manaj, nga AKR-ja Arsim Rexhepi, nga LDD-ja Naser Rugova, nga AAK-ja Ibrahim Selmanaj dhe nga 7+ Enis Kervan.

Lus deputetët që t'i zënë vendet e tyre.

Të nderuar deputetë, po e japim Raportin mbi rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës.

Në mbështetje të Kreut 9 pika 1.26 të Kornizës Kushtetuese dhe të Rregullës 16 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, Komisioni Votues, në përbërje: Sali Rexhepi, kryetar, Xheladin Hoxha, anëtar dhe Natasha Prica, anëtare, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të grupeve parlamentare për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës me votim të fshehtë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, në seancën plenare të legjislaturës së tretë të mbajtur më 9 janar 2008, pas numërimit të votave në votimin e parë konstatoi, si vijon:

Në votim kanë marrë pjesë 115 deputetë. Për Fatmir Sejdiun kanë votuar 62 deputetë, për Naim Malokun 37, të pavlefshme janë 16 fletëvotime. Sipas këtij rezultati, votimi përsëritet.

Lus sekretarinë që t'i bëjë përgatitjen e nevojshme për votim.

Të nderuar deputetë,

Ju njoftoj se tani vazhdojmë votimin e dytë për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës. Edhe në votimin e dytë kërkohen 2/3 e votave, do të thotë 80 vota “për”.

Fillojmë:

Adem Grabovci, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Agim Veliu, Ahmet Isufi, Ali Lajçi, Alush Gashi, Anita Morina, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Arsim Bajrami, Arsim Rexhepi, Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Behgjet Pacolli, Berat Luzha, Blerim Ramosaj, Besa Gaxherri, Bojan Stojanović, Branislav Grbić, Bujar Bukoshi, Donika Kadaj, Dragiša Mirić, Drita Kadriu, Drita Maliqi, Driton Tali, Džezair Murati, Edita Tahiri, Elheme Hetemi, Emursh Xhemajli, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Eqrem Kryeziu, Esat

Brajshori, Eten Arifi, Et'hem Çeku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmire Berisha, Fehmi Mujota, Flora Brovina, Gani Buçinca, Gani Geci, Gani Koci, Gjylnaze Sylja, Hafize Hajdini, Hajdin Abazi, Hajredin Hyseni, Hajredin Kuçi, Haki Shatri, Hashim Thaçi, Heset Cakolli, Hydajet Hyseni – Kaloshi, Ibrahim Gashi, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmanaj, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Kaqusha Jashari, Kolë Berisha, Kosara Nikolić, Ljubiša Živić, Luljeta Shehu, Lulzim Zeneli, Lutfi Haziri, Mahir Yagcilar, Mark Krasniqi, Melihate Tërmkolli, Memli Krasniqi, Mihailo Šćepanović, Mimoza Ahmetaj, Mursel Haljilji, Müfera Şınk, Myrvete Pantina, Myzejene Selmani, Naim Maloku, Naim Rustemi, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Nexhat Daci, Numan Balić, Nurishahe Hulaj, Njomza Emini, Qamile Morina, Radmila Vujović, Ramadan Avdiu, Ramadan Gashi, Ramë Buja, Ramë Manaj, Rasim Selmanaj, Rita Hajzeraj, Riza Smaka, Rrustem Mustafa, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Sadik Idrizi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sanije Aliaj, Selvie Halimi, Skender Hyseni, Slaviša Petković, Slobodan Petrović, Suzan Novobrdaliu, Synavere Rysha, Shkumbim Demaliaj, Špresa Murati, Teuta Hadri, Vezira Emruš, Vladimir Todorović, Vlora Çitaku, Xhavit Haliti, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Zef Morina, dhe të fundit, Zylfi Merxha, Zylfije Hundozi.

Ftoj deputetët që t'i zënë vendet e tyre.

Në sallë janë 70 deputetë, do të thotë mund të japim raportin nga rezultati zgjedhor.

Në mbështetje të Kreut 9 pika 1.26 c të Kornizës Kushtetuese dhe të Rregullës 16 të Rregullores së Punës të Kuvendit të Kosovës, Komisioni Votues në përbërje: Sali Rexhepi, kryetar, Xheladin Hoxha, anëtar dhe Natasha Prica, anëtare, nën mbikëqyrjen e përfaqësuesve të grupeve parlamentare për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës me votim të fshehtë nga deputetët e Kuvendit të Kosovës, në seancën plenare të legjislativës së tretë, të mbajtur më 9 janar 2008, pas votimit të dytë kemi këtë rezultat:

Në votim kanë marrë pjesë 115 deputetë. Për Fatmir Sejdiun kanë votuar 61 deputetë, për Naim Malokun 37, të pavlefshme janë 17 fletëvotime. Me këtë rezultat ne përsëri duhet të shkojmë në votimin e tretë.

Por, para se të bëjmë votimin e tretë, kërkoj që të bëjmë një pauzë prej 10 minutash.

(Pas pauzës)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, vazhdojmë votimin:

Adem Grabovci, Adem Hajdaraj, Adem Salihaj, Agim Veliu, Ahmet Isufi, Ali Lajçi, Alush Gashi, Anita Morina, Ardian Gjini, Armend Zemaj, Arsim Bajrami, Arsim Rexhepi, Bahri Hyseni, Bajram Kosumi, Behgjet Pacolli, Berat Luzha, Berim Ramosaj, Besa Gaxherri, Bojan Stojanović, Branislav Grbić, Bujar Bukoshi, Donika Kadaj, Dragiša Mirić, Dritë Kadriu, Dritë Maliqi, Driton Tali, Xhezair Murati, Edita Tahiri, Elheme Hetemi, Emursh Xhemajli, Enis Kervan, Enver Hoxhaj, Eqrem Kryeziu, Esat Brajshori, Etem Arifi, Ethem Çeku, Fatmir Limaj, Fatmir Rexhepi, Fatmire Berisha,

Fehmi Mujota, Flora Brovina, Gani Buçinca, Gani Geci, Gani Koci, Gjylnaze Syla, Hafize Hajdini, Hajdin Abazi, Hajredin Hyseni, Hajredin Kuçi, Haki Shatri, Hashim Thaçi, Heset Cakolli, Hydajet Hyseni – Kaloshi, Ibrahim Gashi, Ibrahim Makolli, Ibrahim Selmanaj, Ismet Beqiri, Jakup Krasniqi, Kaqusha Jashari, Kolë Berisha, Kosara Nikolić, Ljubiša Živić, Luljeta Shehu, Lulzim Zeneli, Lutfi Haziri, Mahir Yagcilar, Mark Krasniqi, Melihate Tërmkolli, Memli Krasniqi, Mihailo Šćepanović, Mimoza Ahmetaj, Mursel Haljilji, Mufera Sinik, Myrvete Pantina, Myzejene Selmani, Naim Maloku, Naim Rustemi, Nait Hasani, Naser Osmani, Naser Rugova, Nekibe Kelmendi, Nerxhivane Dauti, Nexhat Daci, Numan Balić, Nurishahe Hulaj, Njomza Emini, Qamile Morina, Radmila Vujović, Ramadan Avdiu, Ramadan Gashi, Ramë Buja, Ramë Manaj, Rasim Selmanaj, Rita Hajzeraj, Riza Smaka, Rrustem Mustafa, Sabit Rrahmani, Sabri Hamiti, Sadik Idrizi, Safete Hadërgjonaj, Sala Berisha-Shala, Sanije Aliaj, Selvie Halimi, Skënder Hyseni, Slaviša Petković, Slobodan Petrović, Suzan Novobrdaliu, Synavere Rysha, Shkumbim Demaliaj, Shpresa Murati, Teuta Hadri, Vezira Emruš, Vladimir Todorović, Vlora Çitaku, Xhavit Haliti, Xhevdet Neziraj, Zafir Berisha, Zef Morina, dhe për fund, Zylfi Merxha, Zylfije Hundozi.

Ftoj anëtarët e Komisionit Monitorues që t'i zënë vendet e tyre.

(Duartrokitje)

Të dëgjojmë Raportin mbi rezultatin e votimit për zgjedhjen e Kryetarit të Kosovës, në votimin e tretë.

Në mbështetje të Kreut 9, pika 1.26, pika c të Kornizës Kushtetuese dhe të Rregullës 16 të Rregullores së Punës Të Kuvendit të Kosovës, Komisioni Votues, i përbërë nga tre zyrtarë dhe anëtarë të grupeve parlamentare, ka dhënë këtë raport më 9 janar 2008, në orën 16,00:

Në votim kanë marrë pjesë 118 deputetë. Për Fatmir Sejdiun kanë votuar **68 deputetë**, për Naim Malokun, 39 deputetë, të pavlefshme kanë qenë 11 fletëvotime.

Është votimi i tretë. Zotit Fatmir Sejdiu i urojmë zgjedhjen President i Kosovës me mandat 5- vjeçar.

(Duartrokitje)

Zoti President, foltorja është e juaja.

PRESIDENTI: I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit, Jakup Krasniqi,
I nderuari Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm, zoti Ruecker,
I nderuari përfaqësues i Bashkimit Evropian, zoti Jonsson,
E nderuara zonja Kajdanov, udhëheqëse e Zyrës Diplomatike Amerikane në Prishtinë,
I nderuari zoti Hashim Thaçi, mandatar për formimin e Qeverinë se re të Kosovës,
Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Uvaženi poslanici,
Ladies and Gentlemen,

Më lejoni, para së gjithash, t'ju shpreh mirënjohjen dhe falënderimin tim të thellë për besimin që ma dhatë për të qenë edhe një mandat në krye të institucionit të Presidentit të vendit.

Me këtë rast dëshiroj të falënderoj këtë qasje kaq të thellë të përkushtimit tuaj për zhvillimin e demokracisë dhe dëshmimin e saj në praktikë dhe në të njëjtën kohë garën dinjitoze të kandidatit tjetër, zotit Naim Maloku.

Dua të zotohem para jush, të nderuar deputetë, dhe para qytetarëve të Kosovës se do të vihem me të gjitha fuqitë dhe dijen time në mbrojtjen dhe respektimin e ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë. Kujdes të veçantë do t'i kushtoj ruajtjes së unitetit demokratik të vendit dhe me të gjitha energjitë do të angazhohem për të mirën e gjithë qytetarëve të Kosovës, vendit tonë të dashur. Sot po e përmbyllim një proces të rëndësishëm demokratik nëpër të cilin ka kaluar populli i Kosovës mbi bazën e zgjedhjeve parlamentare të nëntorit 2007 dhe po hapim një kapitull të veçantë, duke përfunduar procesin e konstituimit të institucioneve demokratike në mbështetje të vullnetit politik të popullit të Kosovës.

Qytetarët e Kosovës dhe të gjitha partitë politike, koalicionet, iniciativa qytetare dhe kandidatët e pavarur që morën pjesë në këto zgjedhje, treguan pjekurinë e lartë politike, duke kaluar me sukses këtë sprovë të madhe dhe duke dëshmuar kulturë të lartë politike dhe shtetformuese. Rrallë mund të gjendet një vend i cili ka kaluar me kaq dinjitet dhe sukses sfidat e shumta paralele, siç bëri Kosova në këta majtë e fundit. Për të gjitha institucionet e Kosovës dhe Ekipin e Unitetit, sfida e veçantë ishte angazhimi për përmbylljen e procesit të bisedimeve për statusin politik që është bërë në mënyrën më të mirë të mundshme dhe në të njëjtën kohë mbajtja e një procesi zgjedhor demokratik që u përshkua me një konkurrencë të theksuar në prezantimin e programeve gjatë fushatës elektorale. Kosova arriti me sukses ta mbajë unitetin e saj veprues dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e funksionimit demokratik të institucioneve të saj, duke u falënderuar, në radhë të parë, përputhshmërisë së plotë të qëndrimeve të spektrit politik dhe institucional sa i përket çështjes themelore - pavarësisë së Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Jam i bindur se institucionet e reja të Kosovës, Presidenca, Qeveria dhe Kuvendi i fuqishëm me energji të përbashkët do të japin kontributin maksimal të tyre në zhvillimin dhe konsolidimin e mëtejshëm të demokracisë në Kosovë. Para së gjithash, para institucioneve të reja të Kosovës shtrohen disa detyra themelore, të cilat, jam i bindur se me sukses do t'i përmbarojmë.

Institucionet e Kosovës, Presidenca, Qeveria dhe Parlamenti, si institucione më të larta përfaqësuese dhe ekzekutive, do të përmbyllin me sukses procesin e pavarësimit të Kosovës në realizimin e vullnetit legjitim të popullit të saj dhe do ta miratojnë

Kushtetutën e shtetit të ardhshëm të Kosovës. Do ta zgjerojnë korpusin legjislativ në përputhje me pakon e Presidentit Ahtisari dhe me standardet më të larta bashkëkohëse ndërkombëtare, si dhe gjithë korpusin legjislativ të nevojshëm për ta mbështetur funksionimin e institucioneve demokratike të saj dhe të mirëqenies së përgjithshme të qytetarëve. Do t'i ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme që të përshpejtojmë integrimin e Kosovës në strukturat euroatlantike si orientim themelor i shtetit të Kosovës.

Jam i bindur, se të gjitha forcat politike do të mbajnë frymën e bashkëpunimit të frytshëm për të siguruar edhe më tutje funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës në të mirë të interesave të vendit. Po ashtu, institucionet e Kosovës do të bashkëpunojnë ngushtë me praninë ndërkombëtare civile dhe ushtarake në periudhën shumë të rëndësishme dhe vendimtare në të cilat po hyjnë vendi ynë.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Më lejoni të theksoj se Kosova e pavarur, e cila shpejt do të marrë edhe bekimin ndërkombëtar, do të jetë thellësisht e përkushtuar në bashkëpunimin dhe zhvillimin e një fqinjësie të mirë me të gjitha vendet e rajonit, duke qenë faktor stabiliteti për këtë pjesë të Evropës dhe të botës.

Në veçanti, institucionet e Kosovës janë të përkushtuara që t'i mbrojnë dhe t'i garantojnë liritë dhe të drejtat e të gjitha grupeve etnike jo shumicë. Kujdes i veçantë do t'i kushtohet mirëqenies dhe integritit të plotë të komunitetit serb në Kosovë. Institucionet e reja të Kosovës synojnë një Kosovë, shtëpi dhe mundësi të barabartë për të gjithë.

Duke qenë i bindur në përkushtimin e institucioneve të Kosovës për ta qar përpara shtetin e ri të Kosovës, më lejoni që t'ju dëshiroj shëndet dhe punë të mbarë e të suksesshme në përmbushjen e mandatit dhe të objektivave tuaja të përgjithshme dhe tonat të përbashkëta. Jemi dhe jam i sigurt se së bashku do të t'ia dalim. Ju faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Tani kemi 20 minuta pauzë dhe pastaj do të kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës - zgjedhja e Kryeministrit dhe e Kabinetit Qeveritar të tij.

(Pas pauzës)

KRYETARI: Në sallë janë të pranishëm 108 deputetë. Mund të vazhdojmë punën. Pika e radhës është:

- Zgjedhja e Kryeministrit dhe e Qeverisë së Kosovës

Në bazë të marrëveshjes së partive politike në koalicion, si dhe në pajtim me Kreun IX, pika 3.8 dhe pika 9.3.9 të Kornizës Kushtetuese, ftoj Presidentin e Kosovës, zotin Fatmir Sejdiu, që të bëjë propozimin e kandidatit për Kryeministër të Kosovës.

PRESIDENTI FATMIR SEJDIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë dhe mysafirë të nderuar prezentë në këtë seancë të rëndësishme të Kuvendit,

Kohë më parë, duke pasur parasysh përmbylljen e procesit me konfirmimin e rezultateve nga zgjedhjet e 17 nëntorit të vitit 2007, unë kam kërkuar nga zoti Hashim Thaçi, si udhëheqës, Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, fituese e zgjedhjeve, që të fillojë konsultimet e nevojshme për formimin e Qeverisë së re. Dhe, sot, duke u mbështetur në Kornizën Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, neni 9.2.4 (b), si dhe duke respektuar marrëveshjen e koalicionit në mes të Partisë Demokratike të Kosovës dhe Lidhjes Demokratike të Kosovës, marr këtë

V E N D I M

1. Nominohet zotin Hashim Thaçi, Kryetar i Partisë Demokratike të Kosovës, për mandatar të Qeverisë së re të Kosovës;
2. Kandidati i nominuar, zoti Hashim Thaçi, para Kuvendit të paraqesë përbërjen e Qeverisë së re, në mënyrë që Kuvendi të procedojë me votimin e saj.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Para se kandidati i nominuar për Kryeministër ta paraqesë ekspozenë e tij, fjalën e ka kërkuar anëtari i Kryesisë dhe shef i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, zoti Eqrem Kryeziu.

EQREM KRYEZIU: Faleminderit, zoti Kryetar!

Unë dola këtu në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës, i cili grup, në tërësi, jo vetëm që shpreson, por është i bindur se Qeveria e zotit Thaçi do të ketë integritetin e vet dhe do të jetë një Qeveri funksionale dhe e përgjegjshme.

Së këndejmi, ne e mbështesim tërësisht kandidaturën e zotit Thaçi për Kryeministër të Kosovës.

KRYETARI: Faleminderit! Zoti Thaçi, e keni fjalën për të paraqitur ekspozenë.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, zoti Kryetar! Faleminderit, zoti President!

I nderuari Kryetar i Kosovës,

I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar deputetë të Kuvendit të Kosovës,

Të nderuar qytetarë të Kosovës,

I nderuari zoti Ruecker, zonja Tina Kajdanov, zoti Jonsson,

Të nderuar të gjithë ju – diplomatë, që jeni sot në këtë seancë të Parlamentit të Kosovës,
Të nderuar të gjithë ju mysafirë,
Përshëndetjet më të sinqerta për prezencën tuaj sot këtu dhe për përkushtimet e përbashkëta!

Sot, ndjem i nderuar që, para jush dhe qytetarëve të Kosovës, kam rastin të paraqes fjalimin – ekspozenë e Qeverisë së Kosovës.

Më lejoni që në fillim t’i falënderoj të gjithë qytetarët e Kosovës për mbështetjen e dhënë, si dhe Kryetarin e Kosovës për dhënien e mandatit për formimin e Qeverisë, detyrë kjo që me kënaqësi e kam pranuar dhe me nderë e përgjegjësi do ta ushtroj.

Ky vit, që sapo filloi, sjell para nesh – si vend dhe popull, jo vetëm ballafaqime dhe sfida të shumta, por edhe shpresën dhe besimin e ringjallur me plotë mundësi për të ecur bashkërisht përpara.

Është e vërtetë, sot ndodhemi në udhëkryqin më të rëndësishëm të historisë sonë të re, si vend.

Ne jemi duke u përgatitur që, në fillim të pjesës së parë të këtij viti, ta bëjmë Kosovën e pavarur dhe sovranë, vend të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët e saj. Të drejtat e minoritarëve do të respektohen dhe garantohen përmes angazhimeve afirmative, të përgjegjshme, të garantuara edhe me Kushtetutë.

Për Kosovën e pavarur dhe demokratike, qytetarët tanë janë të bashkuar si asnjëherë më parë. Ne jemi në një krah dhe të koordinuar ngushtë me miqtë tanë, me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Bashkimin Evropian dhe NATO-n. Ëndrrën dhe të drejtën tonë do ta bëjmë realitet, shpejt. Kosova do të bëhet pjesë e familjes së popujve të lirë të botës.

Politika qeverisëse e Kosovës çdoherë do të mbetet e rrënjësuar në të drejtën e qytetarëve tanë. Kosova do të jetë e pavarur.

Mirëpo, nuk duhet të harrojmë se pavarësia e shumëpritur nuk do t’i zgjidhë të gjitha problemet e vendit dhe të qytetarëve.

Bashkë me pavarësinë do të vijmë edhe shumë sfida tjera, me të cilat do të ballafaqohemi bashkërisht. Është obligim i yni ndaj qytetarëve që të krijojmë lidhë të ri dhe të fuqishëm, të vendosur, i cili, do të punojë me nder dhe përkushtim të lartë për të bërë shtetin tonë të ri të respektuar.

Të nderuar deputetë,

Agjenda të cilën po e shpaloj sot para jush, qëllim parësor ka ndryshimet reale e të menjëhershme, gjithëpërfshirëse dhe rrënjësore. Pikërisht, ato ndryshime në të cilat besuam, i kanë kërkuar dhe i presin qytetarët tanë.

Qytetarët tanë me të drejtë janë duke pritur dhe janë duke vëzhguar me kujdes punën tonë. Ata kanë kërkuar dhe janë përcaktuar për ndryshime. Ata janë duke pritur veprime konkrete dhe të menjëhershme.

Prandaj, duke filluar këtu, që nga sot, ne duhet t'i përmbushim pritjet e tyre, që janë edhe zotimet tona.

Deputetë të nderuar,

Agjenda e Qeverisë së Kosovës për reforma dhe ringjallje është specifike dhe e gjerë. Ajo i qartëson prioritetet, mirëpo më lejoni edhe t'i sqaroj. Ajo, nuk paraqet listë të të gjitha problemeve që do të zgjidhen gjatë vitit 2008.

Sfidat tona janë të shumta. Mirëpo, qëllimet tona janë të fokusuar. Së bashku duhet të fillojmë dhe duhet të fillojmë punën e gjithanshme për ndërtimin e vendit tonë të ri.

Zonja dhe zotërinj,

Në javët vijuese, unë, në emër të Qeverisë së Kosovës, do ta prezantoj para qytetarëve projektin gjithëpërfshirës për reformat ekonomike. Ky plan do të fillojë të ngjallë ekonominë kosovare me qëllim që ta shpie vendin tonë në epokën e re të zhvillimit të qëndrueshëm dhe të mundësive të reja. Kjo epokë ndërtohet duke krijuar një klimë, në të cilën, investitorët jo vetëm që mund të vijnë dhe të investojnë në Kosovë, por ata mund të operojnë pa probleme, t'i zgjerojnë bizneset e tyre dhe të krijojnë vende të reja pune. Në këto përpjekje do të udhëhiqemi me një disiplinë, transparencë dhe kujdes të madh financiar. Ne do të sigurohemi që projektet tona kapitale, të parapara për këtë vit dhe vitet vijuese, të financohen ashtu siç duhet dhe që buxheti të jetë në përputhje të plotë me këto projekte.

Prandaj, Qeveria e re e Kosovës do të bëjë një rishikim të tërësishëm të buxhetit të konsoliduar të Kosovës për vitin 2008.

Ne do të jemi të bashkuar në qëllimin tonë për të shënuar rritje ekonomike, duke u pajtuar për uljen e tatimit për biznese, që është më i larti në rajon.

Në gjendjen e tanishme, motivi i investitorëve për të ardhur dhe investuar në Kosovë është shumë i ulët. Ulja e kësaj takse do të dërgojë mesazh të qartë për tërë botën se Kosova është e hapur për biznes.

Veprimi tjetër, që duhet ta bëjmë së bashku, është sigurimi i kredive me kamata të ulëta dhe afatgjate. Ato kredi do të jenë të përshtatshme për bizneset dhe do ta vërtetojnë faktin se në Kosovë mund të krijohen vende të reja pune.

Të shkojmë me hap më tutje. Zotohemi për krijimin e zonave industriale, të cilat do ta stimulojnë rritjen ekonomike.

Përmes lehtësirave të ndryshme tatimore, të dizajnuara për të tërhequr biznese të reja në Kosovë, bizneseve ekzistuese do t'iu krijojmë mundësi të zgjerimit dhe të krijimit të më shumë vendeve të punës.

Që të dëshmojmë se Kosova është e hapur për biznese, ne duhet të ballafaqohemi me sfidat më të mëdha ekonomike: - energjinë dhe infrastrukturën.

Deputetë të nderuar,

Përkushtimi ynë për energjinë dhe infrastrukturën do të jetë konkret dhe shumë serioz. Kosova është në terr dhe unë zotohem se do ta nxjerrim bashkërisht në dritë.

Mungesa e vazhdueshme e energjisë do të konsiderohet nga Qeveria e Kosovës si një krizë nacionale. Prandaj, Qeveria do të përgatit një pako të reformave të gjithanshme për t'i tejkaluar problemet ekzistuese, për të garantuar furnizim të rregullt dhe normal me energji.

Unë kërkoj ndihmën tuaj për të gjetur zgjidhje të shpejta për problemet ekzistuese. Në këtë aspekt, unë do të jem dhe kërkoj edhe nga ju që të jemi inovativë. Do t'i studiojmë të gjitha mundësitë alternative të energjisë, duke u nisur nga energjia diellore e deri tek ajo e erës dhe të sigurohemi për përmbushjen e nevojave tona.

Do të vazhdojmë përpjekjen për ta bërë Kosovën vendin më të gjelbër në Evropën Lindore. E gjithë bota është duke u përballur me dilemën se ku do ta gjejmë energjinë e domosdoshme për furnizimin e ekonomisë globale të shekullit XXI pa shkaktuar dëme të pariparueshme për ambientin tonë natyror. Përse të mos bëjmë përpjekje që ta bëjmë Kosovën një vend që do të mund t'i japë përgjigje kësaj çështjeje. Jam i bindur se mund t'i japim përgjigje meritore dhe pozitive.

Ju ftoj që Kosovën ta bëjmë një qendër rajonale, të pastër për kërkimin në lëmin e energjisë, për zhvillimin, prodhimin dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Të sigurohemi që t'i tërheqim kompanitë nga e gjithë bota, të cilat merren me prodhimin e energjisë së pastër, rigjeneruese për të ardhmen.

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Krijimi i rrjetit efikas infrastrukturor ndërkufitar do të jetë gjithashtu prioritet i Qeverisë së Kosovës, duke filluar nga rrugët, auto-rrugët e deri tek hekurudhat. Ne duhet të punojmë së bashku që t'i modernizojmë ato dhe të ndërtojmë infrastrukturë të re për ta lidhur vendin tonë me çdokënd. Projektet tona janë të qarta. Ne do ta integrojmë infrastrukturën tonë në rrjetin e transportit ndërkombëtar dhe të ecim drejt implementimit të standardeve evropiane.

Kemi premtuar dhe zotohemi edhe sot se do të fillojmë ndërtimin e auto-rrugëve Prishtinë-Hani i Elezit, Vërmicë-Merdare, Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë, deri në kufi.

Të nderuar të pranishëm,
Zonja dhe zotërinj deputetë,
Projekti ynë – i Qeverisë së Kosovës, nuk synon vetëm uljen e shpenzimeve për bizneset, por edhe rritjen e konkurrencës, stimulimin e investimeve dhe krijimin e vendeve të punës.

Zonja dhe zotërinj,
Në ditët e sotme mundësitë varen nga fuqia e dijes. Prandaj, kompanitë janë në gjendje të udhëtojnë në çdo vend të botës për të gjetur këtë fuqi. Kosova, e ka këtë fuqi. Kompanitë investojnë aty dhe lidhen me të.

Do të fillojmë të implementojmë prioritetet tona në fushën e arsimit me qëllim që të ballafaqohemi me sukses me kërkesat e shekullit XXI.

Ju ftoj që ta fillojmë realizimin e qëllimit tonë qysh sot dhe ta bëjmë Kosovën lider rajonal në përgatitjen e studentëve për karrierë në lëmin e matematikës, të shkencës dhe të teknologjisë informative.

Projekti ynë – i Qeverisë së Kosovës, shpalos pakon e detajuar për reformat në arsim. Do ta depolitizojmë arsimin. Reformat në arsim, projekt, i cili do të sigurojë mundësi të reja për studentët tanë dhe do t'i sigurojë prindërit se fëmijët e tyre - fëmijët tanë, do të kenë mundësi të vejnë në funksion potencialin e tyre të jashtëzakonshëm intelektual.

Do ta fillojmë këtë projekt të madh, duke krijuar Fondin Nacional për Arsim, duke i ngritur pagat e mësimitdhënësve, duke i motivuar ata me shpërblime për arritjet në punë. T'i ndihmojmë lokalitetet tona, duke ndërtuar shkolla të reja dhe, kështu, të lehtësojmë gjendjen e rëndë apo kritike ekzistuese.

Përveç kësaj, menjëherë, do të fillojmë me vendosjen e qendrave kompjuterike në shkollat tona, me qëllim që kjo jo vetëm t'i lidhë shkollat ndërmjet veti, por edhe me shtetet tjera të botës. Por, përderisa të fillojmë me vendosjen e qendrave kompjuterike në çdo shkollë të Kosovës, duhet që nxënësit, të cilët ende mësojnë në kontejner, t'i nxjerrim nga kontejnerët duke iu ndërtuar shkolla të reja. Ky është zotimi. Kjo është përgjegjësia dhe kjo do të realizohet shpejt.

Do të krijojmë një sistem të vlerësimit të dijes për nxënësit dhe do të punojmë intensivisht në licencimin e arsimtarëve.

Do të krijojmë një sistem universitar të shekullit XXI, i cili siguron kuadro të specializuara në matematikë, në shkencë dhe në teknologjinë informative. Një sistem, i cili iu mëson studentëve tanë shkathtësi të domosdoshme për të arritur suksese në ekonominë e avancuar të së nesërme. Së bashku, ta bëjmë arsimin një aset të dobishëm për gjeneratat e ardhshme - fëmijët tanë, që ata të korrin suksese në karrierën e tyre, inovatorë dhe kreatorë të së nesërme.

Të nderuar deputetë,
Zonja dhe zotërinj,

Fokusimi në ekonomi, në energji, në infrastrukturë dhe në arsimim do të na mundësojë që të rrisim edhe buxhetin tonë të kufizuar. Kjo rritje na lejon pastaj që të koncentrohemi në programet sociale, për të cilat vendi ka aq shumë nevojë.

Derisa të vazhdojmë të ecim përpara së bashku, do t'iu sigurojmë qytetarëve tanë sistem shëndetësor të nivelit të parë dhe të fillojmë krijimin e një sistemi, në të cilin, të gjithë qytetarët do të kenë sigurime shëndetësore qoftë private apo publike.

Zotohemi sot se Qeveria jonë do t'u kushtojë kujdes të madh të moshuarve dhe do ta reformojë fondin pensional, me qëllim që, nga ai fond, të bëhen investime dhe nga ai fond të mundësohen, edhe në rrugën tonë, lehtësime për sigurimin e barërave si dhe sigurimin shëndetësor për të moshuarit.

Të nderuar deputetë,

Të gjitha këto iniciativa, do të jenë të pakuptimta, në rast se nuk do të kemi Qeveri të hapur dhe transparente. Unë dua të besoj se, ashtu siç e kemi respektuar gjithë agjendën, kohën – edhe të organizimit të zgjedhjeve, të lira demokratike, edhe të angazhimeve për ndërtimin e institucioneve, një proces krejt transparent – Qeveria e Kosovës zotohet se do të jetë transparente me qytetarët, do të jetë transparente në kuptimin e mirëfilltë të funksionimit të saj.

Unë dua ta nxjerr Qeverinë nga mjegulla dhe do ta bëjë atë të përgjegjshme para qytetarëve, të cilëve ajo do t'iu shërbejë plotësisht.

Unë zotohem se do t'i jap fund ciklit të vazhdueshëm të humbjeve, të mashtrimeve dhe të abuzimeve me para të qytetarëve tanë. Do t'i mbetem besnik besimit të dhënë nga qytetarët e Kosovës. Do të kërkoj nga secili ministër që ta bëjë të njëjtin zotim.

Lufta kundër korrupsionit do të jetë e ashpër dhe me zero tolerancë ndaj kujtdo dhe kurdoherë që paraqitet. Prandaj, kërkoj mbështetjen tuaj, të institucioneve përgjegjëse vendore dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Të nderuar deputetë,

Në kohët që vijjnë, Kosova do t'i formësojë institucionet e veta demokratike edhe më tutje. Do të funksionojë si një shtet i plotë në tërë territorin e saj.

Më lejoni që t'u drejtohem qytetarëve të vendit.

Qytetarë të Kosovës,

Unë kërkoj unitetin tuaj të vazhdueshëm. Më keni votuar për unitet e bashkim, zotohem se do ta mbaj vendin unik e të bashkuar. Kërkoj unitetin tuaj të vazhdueshëm, besimin dhe mirëkuptimin. Do të kemi vështirësi e pengesa, por do t'i tejkalojmë bashkërisht të gjitha. Sfidat, me të cilat ballafaqohemi, nuk janë të pakta dhe zgjidhjet nuk mund të jenë aq të lehta dhe të shpejta.

Programi, që do ta prezantoj, do të fillojë të zbatohet në praktikë që nga sot, por nuk do të mund të përfundojë gjatë vitit të parë të Qeverisë së re. Do të kemi udhëtim të gjatë bashkërisht. Besoj në suksesin e plotë të përbashkët të të gjithë spektrit politik dhe qytetar, me mbështetjen ndërkombëtare.

Pra, bashkohuni me mua që të fillojmë këtë udhëtim që nga sot. Të fillojmë të bashkuar me shpirtin e shpresës, të besimit, të vendosmërisë dhe të mundësive të reja.

Deputetë të nderuar,

Zonja dhe zotërinj,

Mysafirë të nderuar,

Ju ftoj sot që ta votoni këtë agjendë, për këtë Qeveri dhe për qytetarët të cilët do të na ndihmojnë në rrugën tonë. Vota juaj iu dërgon mesazh të qartë atyre që i përfaqësoni, që na kanë votuar. Ju iu keni thënë atyre se jeni të gatshëm që të jeni liderë të fuqishëm për ta udhëhequr vendin, ashtu siç ata duan, që t'i bëni ndryshimet e vërteta që ata i kërkojnë dhe ta ndërtoni vendin e ri, ashtu siç e meritojmë. Unë zotohem se, të bashkuar, mund t'i arrijmë objektivat tona për të mirën e vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës. Faleminderit! Respekt!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Ftoj Kryeministrin, që ta paraqet listën e ministrave dhe të zëvendësministrave.

KRYEMINISTRI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Më lejoni që t'i prezantoj para Kuvendit të Kosovës kandidatët, bartës të dikastereve të reja të Qeverisë së Kosovës, të propozuarit për zëvendëskryeministra dhe për ministra.

- Zëvendëskryeministër, prof. dr. Hajredin Kuqi;
- Zëvendëskryeministër, zoti Ramë Manaj;
- Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit, ministër zoti Fatmir Limaj;
- Ministria e Ekonomisë dhe e Financave, ministër Ahmet Shala;
- Ministria e Shëndetësisë, prof. dr. Alush Gashi, ministër;
- Ministria e Drejtësisë, zonja Nekibe Kelmendi, ministre;
- Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë, ministër prof. dr. Enver Hoxhaj;
- Ministria e Tregtisë dhe e Industrisë, ministër Lutfi Zharku;
- Ministria e Pushtetit Lokal, Sadri Ferati, ministër;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, ministër Skender Hyseni;
- Ministria e Bujqësisë, ministër, prof. dr. Idriz Vehapi;
- Ministria e Punëve të Brendshme, ministër Zenun Pajaziti;
- Ministria e Ambientit dhe e Planifikimit Hapësinor, ministër Mahir Jagcillar;
- Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, Nenad Rašić, ministër; Gjergj Dedaj, zëvendësministër;
- Ministria e Energjetikës dhe e Minierave, ministre, prof. dr. Justina Pula-Shiroka;

- Ministria e Shërbimeve Publike, ministër, prof. dr. Arsim Bajrami;
- Ministria e Kthimit dhe e Komuniteteve, ministër Boban Stanković.

Kjo është lista e propozuar nga unë, si i mandatuar për të udhëhequr Qeverinë e ardhshme të Kosovës, është lista e koalicionit – partner të koalicionit të ardhshëm. Faleminderit! Urime, suksese!

KRYETARI: Të nderuar deputetë,
Dëgjuam ekspozenë e të nominuarit për Kryeministër të Kosovës, dëgjuat edhe emrat e kandidatëve për ministra në Qeverinë e Kosovës.

Tani është radha që të votohet për Kryeministrin dhe për Qeverinë e Kosovës.

Kryeministri, zëvendëskryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat zgjedhën me votën e shumicës së deputetëve të Kuvendit – me 61 vota.

Mënyrën e votimit, e përcakton Kuvendi në bazë të Rregullores së Punës, Rregulla 18.3.

Shkojmë me votim të hapur.

(Reagim – nuk dëgjohej për transkriptim)

Unë në ekran nuk e kam asnjë emër të lajmëruar për të marrë fjalën. Tash, duket se paraqitet Besa Gaxherri. E ka fjalën Gani Geci.

GANI GECI: Të nderuar kolegë deputetë,
Të nderuar përfaqësues të zyrave perëndimore,
I nderuar zoti Kryetar,
I nderuari zoti Ruecker,

Unë, para se të votohet për Qeverinë e zotit Kryeministër, desha të përkujtoj, kolegë të nderuar deputetë, se në programin e tij – zoti Kryeministër, si duket e ka harruar Mitrovicën. Mitrovica është një problem nacional i Kosovës dhe ne, si deputetë të opozitës, do t'i ndihmojmë zotit Bajram Rexhepi, kryetar i Mitrovicës. Për këtë do të zotohemi, prandaj zoti Kryeministër, besoj se edhe ju do ta mbështetni. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! E ka fjalën Ahmet Isufi.

AHMET ISUFI: I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit,
I nderuari zoti Kryetar i Kosovës,
I nderuari zoti mandatar për Kryeministër,
I nderuar zoti Ruecker,
Zonja Tina Kajdanov,
Të nderuar deputetë,
Me Qeverinë, që po ofrohet sot para Parlamentit të Kosovës dhe para qytetarëve të Kosovës, jemi të bindur se nuk do të ketë rrugë ashtu siç e mendojnë ata që e kanë

krijuar, sepse e kanë krijuar mbi një bazë të një interesi të ngushtë, duke u kufizuar në apetitet personale të liderëve politikë, të cilët, në fakt, edhe pasi thuhet se mandati zgjedhor iu garanton dhe s'ka ndonjë ndryshim – ndryshohet Korniza kushtetuese, ndryshohet mënyra e qasjes ndaj rendit kushtetues në Kosovë. Prandaj, këtu kemi një shkelje, të cilën konsiderojmë se në të ardhmen nuk duhet lejuar të bëhet, sepse Parlamenti i Kosovës është ai që duhet të vendosë për aktet ligjore dhe kur në Parlament votohet - edhe Kryeadministratori zoti Ruecker mund ta nënshkruajë, por jo që të përmbushen disa nga interesat e ngushta politike të partive, të cilat sot kanë ofruar koalicion.

Një element tjetër, është ai i thirrjes për votëbesimin, që duan të krijojnë një pushtet të absolutizmit, të mosshikimit të interesit të Parlamentit të Kosovës, të Qeverisë së Kosovës, të interesave të qytetarëve të Kosovës. Dhe, unë, konsideroj se këtu ka shkelje të drejtpërdrejta të interesit tonë të përgjithshëm. Sepse, kjo edhe në të ardhmen mund të na përsëritet dhe nuk duhet ta lejojmë.

Para këtij mandati kemi pasur një qeverisje, e cila, që në start, pikërisht nga partnerët e sotëm në koalicion – me të cilin ka lidhur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës partneritet me Lidhjen Demokratike të Kosovës, është thyer ky partneritet, është sulmuar keq dhe madje është shkuar aq larg dhe deri te fyerja e ndjenjave njerëzore, familjare, shoqërore dhe në të gjitha kuptimet.

Nëse duhet të kthehemi pak në ndërgjegjen tonë, kisha lutur deputetët e Partisë Demokratike të Kosovës që, nga kjo foltore kanë fyer ish-kryeministrin Haradinaj, të dalin e t'i kërkojnë falje, sepse kanë fyer në mënyrë të rëndë dinjitetin personal të tij, edhe në kushtet të cilat i dinë të gjithë deputetët e Parlamentit të Kosovës. Dhe tani bëhet një kurorëzim po me ata që janë quajtur deri dje keqqeverisës, shkelës të të gjitha interesave të qytetarëve, me Lidhjen Demokratike, e cila, në fakt, është ofruar si partner dhe tani ju duket shumë i hijshëm, shumë i mirë.

Nuk ka dy kute. Ka vetëm një. Prandaj, ne, partneritetin politik, edhe në të kaluarën e kemi parë si interes politik. E kemi parë shumë qartë. Dhe, mirë që më në fund e keni mësuar, por është mirë të keni kujdes. Kur e thoni fjalën, pas një viti, pas dy vitesh, pas tri vitesh – mbajeni në mend, se mund të pendoheni. Sepse, të njëjtin veprim sot po e bëni në Parlamentin e Kosovës pa u skuqur fare, madje nga dëshira, jo shumë të shtyrë për interesa më të mëdha.

Ekspozeja, që u paraqit këtu, u paraqit në mënyrë aq të shkurtuar sa nuk lejon mundësinë që në fakt të shihet se çka do të bëhet në të ardhmen me Kosovën në ato sfera të cilat sot ka nevojë qytetari i Kosovës, në ato sfera në të cilat ka nevojë Kosova, në gjendjen në të cilën gjendet Kosova.

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës do të veprojë shumë aktivisht në të gjitha nivelet ku e kërkon angazhimi për krijimin e shtetit të Kosovës. Ne aty asnjë dallim s'do të kemi. Por, në qasjet tuaja, që mund të jenë për interesa të ngushta dhe për interesa, që në fakt, i paraqitët edhe sot këtu, do të jemi shumë konsekuentë që të mos lejojmë të ndodhin gjëra

të tilla. Do të jemi partnerë shumë të fuqishëm edhe me diplomacinë ndërkombëtare, do të vazhdojmë të punojmë në interes të Kosovës dhe për asnjë interes tjetër dhe do të mundohemi që në këtë plan të jemi bashkë. Për ato, që do të jenë kritika për të ardhmen, do të shihemi pas 100 ditësh.

Konsiderojmë se ky kurorëzim që është bërë sot, është bërë, që thuhet te ne – për letra, sa për të kryer pak punë, por në 101-ditëshin ne urojmë që të përfundojë ky koalicion, të kemi një gjendje tjetër, sepse Kosova meriton më ndryshe, meriton më mirë. Meriton një bazë të qeverisjes, e cila mundëson që qytetarët të ndjehen mirë dhe jo të ndjehen të frustruar. Para situatës që jemi, ne kemi nevojë të bashkëpunojmë në të ardhmen, por dijani se keni bërë shumë dëm në të kaluarën për të mos mund kapërcyer hapat që i keni.

Nëse vazhdoni të punoni kështu në të ardhmen, siç keni punuar deri me themelimin e Qeverisë tash, dijani që jeni kah u bëni dëm qytetarëve të Kosovës. Po ashtu, edhe partnerët e deritashëm në koalicion, i falënderojmë për bashkëpunimin që kemi pasur, por megjithatë Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës ka qenë gjithnjë korrekte, nuk i është kthyer me korrektësi të mjaftueshme, jo për lakminë qeveritare, por për mënyrën e sjelljes ndaj Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës.

Ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë. Presim që të na kthehet kryetari Haradinaj dhe të vazhdojmë ta ndërtojmë shtetin e Kosovës bashkë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, i nderuari deputet! Fjalën e ka Behgjet Pacolli, le të përgatitet Sabri Hamiti.

BEHGJET PACOLLI: I nderuari zoti President,
Zoti mandatar për Kryeministër të Kosovës,
Her Ruecker,
Mmiss Kajdanov,
I nderuar zoti Kryetar i Parlamentit,
Kolegë, mysafirë,
Dame i gospodo,

Jam krenar që jam pjesë përbërëse e Parlamentit, i cili, shumë shpejt do të shpallë pavarësinë e Kosovës dhe prej këtu jap betimin tim se do të jem konstruktiv me gjithë qenien time kur është fjala për qytetarin e Kosovës, kur është fjala për Kosovën.

Koalicioni i ri, i porsaformuar, që pritet të votohet, ka ndarë deputetët e Kosovës në dy grupe: ata të ulur kënde, të tjerët të ulur andej, por bëj thirrje te të gjithë që të jemi konstruktivë, të punojmë për Kosovën. Kemi shumë punë për të bërë, puna na pret. Kemi telashe, kemi probleme. Prandaj, edhe për këtë betohem se do të bashkëpunoj me ju.

Në parim, kemi dy gjëra të përbashkëta: pavarësinë e Kosovës dhe mirëqenien e qytetarit të Kosovës, por kemi edhe diçka tjetër – premtimet që gjatë fushatës elektorale ua bëmë qytetarëve të Kosovës dhe me premtimet tona ua morëm votën atyre.

Unë jam i bindur se edhe këta – këndej, bashkë me mua, në këto dy pika, do të jenë konstruktivë dhe do të bashkëpunojmë. Do të bashkëpunojmë për projekte madhore, por ekskluzivisht që shkojnë në interes jo të klaneve, jo të personave, por shkojnë në interes të qytetarit të Kosovës, në interes të Kosovës, në interes të dokumentacioneve që e çojnë Kosovën drejt pavarësisë, në interes të demokracisë për veprime e iniciativa që bazohen në fundamentet e demokracisë dhe janë pjesë përbërëse e Kushtetutës së Kosovës.

Tani, miq të nderuar, dua t'ju them se unë jam dakord me parafolësin tim, zotin Jusufi se, koalicioni juaj, më duket tani joparimor, jo i natyrshëm. Deri dje, keni pasur kundërthënie, ndoshta edhe jeni sharë, jeni fyer në mes veti, e sot jeni së bashku. Besoni se qytetari i Kosovës nuk i ka harruar. Këto kundërthënie janë shumë të freskëta dhe besoni se edhe një pjesë e madhe e ndiejmë ne që jemi në opozitë, një pjesë e madhe e militantëve të juaj nuk janë në dakord me ju dhe ata militantë kam frikë se do t'i humbni. Ata nuk do të humbin, ata i kanë zyrat e veta!

(Duartrokitje)

Zoti mandatar, zoti Kryeministër, ne do të votojmë për ju. Ju keni votën e qytetarit të Kosovës dhe ne do t'ju votojmë, jam i bindur. Ne do t'ju votojmë dhe mbështesim në çdo parim që shkon në interesin e Kosovës, në programet e juaja dhe do të jemi aty ku ju nevojitet prezenca dhe ndihma jonë. Por, mos harroni, 24 orë rrymë, zoti Kryeministër. Mos harroni autostradat në Kosovë. Mos harroni zbutjen e varfërisë. Mos harroni punësimin. Mos harroni sigurimin e qytetarit, se ne jetojmë sot të pasigurt. Mos harroni edukimin, shëndetësinë, mirëqenien e qytetarit.

Prandaj, zoti Kryeministër, të punojmë në mënyrë të denjë, të sinqertë, në mënyrë transparente. Unë jam i bindur se ju do ta bëni këtë, por nevojitet ndihma e qytetarit të Kosovës, e çdo kosovari që është konstruktiv dhe ia don të mirën këtij populli dhe Kosovës, besoj, shumë shpejt - shtetit më të ri në botë.

Qytetari i Kosovës ballafaqohet sot me shumë probleme, me net të gjata e të errëta, me ditë të shkurtra, me dimra të gjatë e të ftoftë, me vera të shkurtra e të thata – zoti Kryeministër. Pak shpresa, shumë depresion. Pak diell, shumë stuhi. Pak mirëqenie, shumë varfëri. Pak të punësuar dhe shumë që presin punësim. 100 ditë kalojnë shpejt. Prandaj, nuk kisha dashur që pas 100 ditësh, prej kësaj foltore t'ju them atë që e keni pasur obligim, atë që e keni premtuar, në bazë të të cilave premtime ju morët votën e qytetarit, që të dështoni. Ju kam mik. Ju dua të mirën, dua suksesin tuaj.

Kur thashë se kjo “martesë” e juaja, nuk është e natyrshme, kam të drejtë. Partneri juaj gjatë fushatës elektorale nuk ka kërkuar një fillim të ri, zoti Kryeministër. Ka kërkuar një vazhdimësi të kësaj që kemi tani, me qytetarë të hareshëm. Jo, sot në Kosovë nuk keni qytetarë të hareshëm. Por, ju duhet ta bëni Kosovën të hareshme. Këtë e bëni me një fillim të ri. Ka qenë moto e ime në fushatën elektorale.

Zoti Kryeministër, ju dëshiroj punë të mbarë! Stafit tuaj, që më duket shumë profesional, i dëshiroj sukses dhe të punojmë të gjithë së bashku për Kosovën, për interesin e Kosovës. Falënderoj kolegët e mi që janë këtu dhe mbështetjen e Shteteve të Bashkuara

të Amerikës, mbështetjen e komunitetit evropian dhe mbështetjen e miqve të Kosovës për çka kanë bërë dhe për çfarë janë duke bërë për Kosovën. Faleminderit!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Pacolli! Fjalën e ka deputeti Sabri Hamiti, le të përgatitet Gjylnaze Syla.

SABRI HAMITI: Zoti Kryetar i Kuvendit,
Kryetar i Kosovës,
mandatar për Qeverinë e ardhshme të Kosovës,
Unë dëgjova një paraqitje simbolike inauguruese. Unë besoj që mandatarin do ta paraqet para këtij vendi programin e qeverisë në mënyrë substanciale një herë tjetër, unë kështu e kuptoj, sigurisht. Përndryshe, s'ka si bëhet ndryshe, nën një.

Nën dy, unë dola vetëm t'i them mandatarit se mos harroi apo kaloi pa një kujdes, sepse në mënyrë institucionale, edhe ata zëvendësministra që i kanë anësuar edhe publikisht mbrëmë, duhet të lexohen këtu sepse Qeveria duhet të votohet e plotë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Le të përgatitet, pas Gjylnazës, Lulzim Zeneli.

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit! I nderuari zoti Kryetar,
I nderuari zoti President,
I nderuari zoti Ruecker,
E nderuara zonja Kajdanov,
I nderuari zoti Jonsson,
Të nderuar përfaqësues të zyrave diplomatike, të SHPK-së,
Të nderuar deputetë,
Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Unë do të shpreh kënaqësinë e posaçme që sot mund t'i drejtohem Kuvendit. Po ashtu, gëzohem shumë që, gati pas dy muajsh, u zgjodhën institucionet e Kosovës.

Por, në këtë moment të rëndësishëm, dëshiroj t'i kujtojmë të gjithë ata që u flijuan dhe u sakrifkuan për lirinë tonë dhe për ndërtimin e institucioneve të sotme – luftëtarët e UÇK, familjet e dëshmorëve, invalidët dhe veteranët e luftës.

Mos t'i harrojmë edhe të burgosurit. Të kujtojmë luftëtarët e lirisë në Hagë. Jam e bindur që së shpejti do të jenë në Kosovë, sepse e thanë të vërtetën për luftën e Kosovës dhe për vlerat e saj.

Të kujtojmë edhe dhembjet e familjeve të të pagjeturve, kontributin e jashtëzakonshëm të mësimit dhe të personelit mjekësor, të pensionistëve dhe të diasporës. Që të gjithëve iu kemi borxh që të punojmë për të krijuar shtetin e Kosovës, me shoqëri demokratike dhe tolerante. Ky është obligimi ynë solemn edhe ndaj qytetarëve të Kosovës. Dhe, ky obligim dhe demokraci, nënkupton krijimin e pozitës dhe të opozitës.

Në vazhdim unë të fokusohem në dy çështje. Çështja e parë është qëndrimi ynë në Kuvendin e Kosovës si opozitë. I qëndrojmë besnik procesit demokratik dhe ndërtimit të shtetit demokratik e modern të Kosovës.

Ne, deputetët e Aleancës, do të vazhdojmë të punojmë në të mirë dhe në interes të Kosovës. Sa herë që e kërkon interesi nacional, ne do të bashkëpunojmë dhe do të jemi konstruktivë me opozitën. Po ashtu, do të jemi gjithnjë vigjilentë në mbikëqyrjen e punës së Qeverisë, duke e nxitur atë për një qeverisje më të mirë dhe do të ofrojmë zgjidhje alternative për problemet jetësore të qytetarëve të Kosovës.

Çështja e dytë, për të cilën do të flas, është përmbledhja ekzekutive e programit qeverisës të Qeverisë që e prezantoi mandatarin, zoti Thaçi. Dëshiroj menjëherë të shpreh një vërejtje. Është dashur me kohë ta kemi këtë përmbledhje në mënyrë që të mund ta lexojmë me kujdes dhe t'i japim vërejtjet tona, zoti Thaçi, ashtu që t'ju ndihmojmë në punën tuaj, gjegjësisht Qeverisë së ardhshme. Po, nuk e patëm rastin, vetëm dëgjuam fjalën dhe mundësia që mu dha mua vetëm të dëgjoj fjalën – ekspozenë e zotit Thaçi sot.

Dhe, në bazë të asaj që unë e dëgjova dhe e përcjella me shumë vëmendje, unë do t'i paraqes këto vërejtje:

Programi, është shumë i gjeneralizuar. E vlerësoj se nuk ka definim të qartë të politikave dhe të sferave të ndryshme, të cilat do të më bindin se do të ndikojnë në përmirësimin e jetës së qytetarëve ose në mirëqenien dhe përkujdesjen e pjesëve të ndryshme të shoqërisë, të invalidëve, të dëshmorëve dhe të pensionistëve. Nuk ka as planifikim kohor se çfarë do të bëjë Qeveria në secilin vit të qeverisjes së saj. Kurse, problemet jetësore janë të shumta: papunësia, rryma, uji, varfëria. Dhe, kur folët, zoti Thaçi, për reformat në energji, si dhe për kompjuterizimin e shkollave, do t'ju pyesja juve: si do t'i mbani këta kompjuterë funksional pa një ide të qartë të këtyre reformave?

Dhe, në fund, dëshiroj t'i pyes deputetët: A mund të mbështetni një program të tillë, duke vënë në pikëpyetje zbatueshmërinë e tij. Dhe, pyetja tjetër imja është se: A është programi qeverisës në përputhje me kapacitetet buxhetore të Kosovës dhe në pajtueshmëri me synimet e qytetarëve të Kosovës për një jetë më të mirë.

Shpresoj se vërejtjet e mia do t'i merrni parasysh dhe kur t'i sillni përmirësimet në programin tuaj, shpresoj do t'i diskutojmë prapë. Faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit zonja deputete! Fjalën e ka Lulzim Zeneli, le të përgatitet Ali Lajçi.

LULZIM ZENELI: I nderuari Kryetar i Kuvendit,

I nderuari zoti mandatar,

Sinqerisht t'ju themi, edhe pse është seancë solemne dhe duhet ta ketë karakterin solemn, Lidhja Demokratike e Dardanisë ka pritur sot një qartësim të atij vizioni që shumë herë

është proklamuar si vizion për ndryshime substanciale, si vizion i cili do ta qartësojë ecjen e Kosovës në të gjitha ato poret me të cilat sot ballafaqohemi si shoqëri.

Mirëpo, u tha këtu se nuk është program dhe plotësisht pajtohem me atë se nuk është program. Mirëpo, në këtë aspekt, e cilësojmë që në start se ka një mungesë vizioni dhe lirisht mund të themi një varfëri, e cila, në start mund të demonstrohet e unë besoj se në të ardhmen – në ecje, shumëçka nga kjo do të korrigjohet.

Atë që dola këtu sot të them, është se Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë do të jetë një opozitë e fuqishme konstruktive për të gjitha proceset programore, për të gjitha çështjet zhvillimore në ecjen tonë së bashku si institucione. Kurse, për të gjitha proceset që kanë të bëjnë me shtetësinë e Kosovës, proceset nacionale, mund të llogaritni në një partneritet të fuqishëm, një partneritet serioz të Lidhjes Demokratike të Dardanisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Zeneli! Fjalën e ka deputeti Ali Lajqi, le të përgatitet Naim Maloku.

ALI LAJÇI: I nderuari Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Kryetar i Kosovës po ashtu në veçanti,

Kryeministër që tashmë duhet ta marrë votën,

Unë desha vetëm të shtoj disa nga objektivat që ndoshta duhet t'i përmbajë në kuadër të vet programi i Qeverisë, e që mendoj se kanë një rol shumë jetik dhe pragmatik e strategjik të realizimit të statusit politik, respektivisht të pavarësisë së Kosovës. Kjo ka një rëndësi të veçantë për faktorin ndërkombëtar dhe kombëtar sigurisht duke pasur parasysh çështjen e integritetit territorial të Kosovës dhe strategjitë e tjera që janë në lojë. Duhet të kemi një vëmendje të veçantë ndoshta me një projekt ekstra për Mitrovicën, e cila do të duhej të ishte e përcjellë me vëmendje në rast të shpalljes së pavarësisë, e që do të ketë edhe diskrepanca në mes shpalljes dhe të projektit të Ahtisarit, që do të mund të diskutohet ndoshta në mënyrë të veçantë në kohë të caktuar edhe në momente të caktuara, por që atje të kujdesemi a kemi sigurinë dhe kontrollin, apo jo, në rast të shpalljes së pavarësisë së proklamuar dhe në qoftë se jo, të kujdesemi që përpara të mos gjendemi në një akt të kryer eventual, kur një zyre atje tashmë e hapur diplomatike, që nuk dua të besoj se mund ta luaj nesër, me depërtimin e trupave të huaja aty, të invazionit, të bëjë një qasje të një roli të gjoja të një fleksibiliteti politik, diplomatik e hapësinor, madje edhe territorial e që do të ishte shumë e dëmshme dhe akt i kryer.

E dyta. Të shikojmë me vëmendje si e ndërtojmë politikën e strategjisë së ndërtimit të shtetit sot, në kuptim ndërkombëtar, kur themi shpesh se nuk do të shpallim, apo pavarësia e njëanshme nuk është e pranuar. Jo, ju lutem, pavarësia e Kosovës nuk mund të shpallet në dy anë, tri apo në mes a në skaj, por është një pavarësi e ligjshme e vullnetit të qytetarëve. Në qoftë se këtë e zbërthejmë mirë, e që shpesh kemi dëgjuar se kondicionohet ky emërtim nga politikat më të larta në nivel të Shqipërisë dhe këtu, sepse po të shpallet e njëanshme, nuk do të pranohet. Atëherë, del së paku një neglizhim i saj

dhe unë preferoj që të largohemi nga ky term, sepse kështu kemi një kurth që në mënyrë të tërthortë do të mund të na sjellë.

Prandaj, duhet t'i shikojmë edhe disa çështje të tjera. Ne sot duhet të jemi shumë koshientë për një siguri të përbashkët, një stabilitet politik të faktorit tonë të përbashkët të brendshëm dhe institucional dhe të kemi parasysh që Qeveria, menjëherë, në kuadër të kompetencave çfarë i ka dhe çfarë do t'i ketë, të synojë të marrë sa më shumë, që të bëjë një ndikim të drejtpërdrejtë që Albin Kurti, si një alternativë e mundshme, të kalojë jashtë procedurave – ndjekjeve e të tjera, qofshin ato formale apo joformale, që mund të themi “në thonjëza” dhe se ne nuk na bën nderë që njerëzit që përpiqen me alternativë, të qëlluar apo të paqëlluar, e kjo do analizë, të mos të jenë të trajtuar me procedura ndjekjeje. Nuk na bën nderë, sepse ende nuk e kemi realizuar pavarësinë dhe jemi në procesin e fundit kapital të saj, e të ndjekim njerëz që preferojnë vetëvendosjen, nuk është e ndershme për institucionet e Kosovës, për partitë politike, për Qeverinë që do të vjen e të tjerë. Prandaj, unë do të dëshiroja që këtu të bëhet një ndërhyrje e mundshme për shkak se krijon një siguri, krijon një fuzion të të gjitha përpjekjeve tona për pavarësinë e Kosovës.

Ndryshe, që nga kjo natë, unë mendoj se do të kemi përpjekje që të gjithë së bashku të jemi dhe t'i fuzionojmë këto vepra. Ju dëshiroj sukses, të gjithëve, bashkërisht. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Lajçi! Fjalën e ka Naim Maloku, le të përgatitet Mimoza Ahmetaj.

NAIM MALOKU: I nderuari zoti Kryetar i Kosovës,
I nderuari zoti Kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti Thaçi,
Zoti Ruecker,
Zonja Tina Kajdanov,
Të nderuar deputetë,
Mysafirë të nderuar,
Zonja dhe zotërinj,

Fjala ime sot nuk i përket një deputeti, që është pjesë e opozitës. Unë përshëndes këtë koalicion dhe arritjen e kësaj marrëveshjeje. Por, më lejoni t'ju them diçka. Figurat qendrore të formimit të këtij koalicioni, po të ishin bërë bashkë në të 98-tën lufta do të kishte qenë më pak e dhimbshme, vuajtjet e qytetarëve të Kosovës do të kishin qenë më të vogla, Ushtria jonë Çlirimtare do të kishte qenë më e fuqishme, më shpejt do të kishim dalë prej luftës, shumë dëshmorë i kishim sot në mesin tonë të të gjallëve, ndoshta edhe shumë invalidë nuk do t'i kishim sot invalidë.

Po të ishin bërë këto figura qendrore, që e bënë këtë koalicion sot, bashkë menjëherë pas luftës, statusi i Kosovës do të ishte çështje e harruar. Kosova, kjo është bindje imja, do të ishte në procese të tjera. Pakkush e ka ditur që ju jeni një tërësi – e ndarë në dy pjesë konceptualisht të njëjta dhe që keni gjetur tash veten. Unë ju uroj për këtë. Kilometra

faqe të gazetave tuaja, për këto 8 vite, i keni harxhuar dhe shpenzuar duke akuzuar njëra palë tjetrën. Nuk keni lënë gjë pa thënë njëra palë kundër tjetrës. Shërbimet e juaja, që i keni dy, kanë bërë dosje kundër njëra – tjetrës. Keni vë në lajthitje edhe faktorin ndërkombëtar që ka dashur të na ndihmojë.

KRYETARI: Zoti Maloku, përmbaju temës!

NAIM MALOKU: Unë përshëndes këtë koalicion dhe mendoj që prej sot ju duhet të merreni me vetveten. Ju duhet ndihma jonë, ndihma e Kuvendit dhe posaçërisht ndihma e faktorit ndërkombëtar që ju këtë koalicion ta mbani në të mirë të proceseve pozitive në Kosovë, në të mirë të afrimit të dy poleve të skajshme, që kanë qenë gjer më tani të skajshme. Kjo është e vërteta dhe në të mirë të të ardhmes më të qetë, më stabile dhe më të mirë për të gjithë qytetarët e Kosovës, ju uroj që ky koalicion dhe kjo Qeveri të jetë transparente, ashtu siç keni premtuar. Ne po votojmë sot, ky Kuvend po e voton Qeverinë, jo programin, por emrat. Pra, nuk keni ofruar program para këtij Kuvendi dhe ne shpresojmë, pra unë shpresoj që sa më shpejt të ofroni programin para këtij Kuvendi. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Maloku! Fjalën e ka zonja Mimoza Ahmetaj, le të përgatitet Numan Balić.

MIMOZA AHMETAJ: Faleminderit, zoti Kryetar,
I nderuari Kryetar,
I nderuari i mandatuar për Kryeministër, zoti Thaçi,
I nderuari zoti Ruecker,
Zonja Kajdanov,
Të nderuar deputetë dhe deputete,
Të nderuara zonja dhe zotërinj, mysafir të pranishëm,

Më lejoni që në fillim të uroj institucionet e reja, të cilat sot do të marrin bekimin e Kuvendit dhe t'i përgëzoj ato për vizionin dhe vendosmërinë e tyre që të përballen me sfidat të cilat gjenden para nesh.

Zoti Thaçi, i mandatuar për Kryeministër, në këtë drejtim beteja para jush nuk do të jetë e lehtë. Po trashëgoni një gjendje e cila, mbi të gjitha karakterizohet me një përqindje të lartë të papunësisë dhe të varfërisë, një situatë të rëndë energjetike, një situatë në të cilën shumica e të rinjve, në mungesë të perspektivës, synojnë mërgimin dhe të gjitha këto kurorëzohen natyrisht me sfidën e pavarësimit të Kosovës. Ju vini në kohën kur duhet ta funksionalizoni jo vetëm institucionin, qeverisjen, planifikimin dhe sistemin e menaxhimeve të shumta, të çështjeve dhe të proceseve të mëdha, por duhet ta funksionalizoni edhe sundimin e ligjit me fillimin e reformimit të gjykatave të vendit. Padyshim, do të ketë njerëz që do të kritikojnë, do të ketë edhe të atillë që do të lavdërojnë punën tuaj.

Megjithatë, jam e bindur se me institucionet e reja, të cilat sot do të marrin përsipër një përgjegjësi të madhe, me vizionin për të bërë ndryshime, do të arrijmë aty ku, në fund të

fundit, të gjithë synojmë – tek një e ardhme më e ndritur për të gjithë qytetarët në Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Dhe nëse asgjë tjetër, ky synim na bashkon të gjithëve pavarësisht nga përkatësia partiake dhe kjo duhet të jetë pikënisja e punës sonë. Me këto synime dhe me këto institucione të reja, jam e bindur se Kosova do të përfundojë rrugëtimin e gjatë të popullit shqiptar, vuajtjet e të cilit janë të shumta.

Personalisht, përvoja ime parlamentare fillon gjatë këtij mandati. Megjithatë, kam aq përvojë sa të di se kush meriton të jetë në krye të rrugës përfundimtare që së bashku do ta bëjmë. Prandaj, ju përgëzoj në detyrën e re, zoti Kryeministër. Urime dhe suksese!

KRYETARI: Ju faleminderit! Fjalën e ka Numan Balić, le të përgatitet Riza Smaka.

NUMAN BALIĆ: Još jedan put poštovanje i selam svima koji su prisutni. Pa eto, dobro je da se čuje i neka riječ od ovih drugih zajednica i da se vidi da su i one u Vladi, odnosno Parlamentu, oprostite.

Ja se nadam da ću reći nekoliko riječi vezano za ovakav ton koji je do sada preovladjivao, a koji se ticao konstruktivnog doprinosa u radu budućih institucija Kosova.

Dozvolite mi da budem vrlo pragmatičan i da primjetim neke stvari koje se tiču onoga što bih ja nazvao malim akrobacijama vezano za sastav budueće Vlade. Obratio bih pažnju na tri ministarstva: Ministarstvo za poljoprivredu, Ministarstvo za zdravstvo i Ministarstvo za rad i socijalnu politiku. Kao što znate, ova prva dva ministarstva bila su tradicionalno u sastavu, odnosno predstavljale su ih manjinske zajednice, druge zajednice. Bilo je dobro objasniti zašto je došlo do promjene formule te ministarstava koja su tradicionalno pripadala u oba izborna mandata, a u sve četiri vlade, drugim zajednicama, zašto su sada ona rukovodjena od predstavnika političkih partija iz vladajuće koalicije. I, naravno, Ministarstvo za rad i socijalna pitanja, ministarstvo koje je takodje veoma važno, ministarstvo koje se bavi pitanjem rada i zapošljavanja, ministarstvo koje se bavi pitanjem socijalne politike i ono koje se bavi pitanjem penzija, naravno uzimajući u obzir i pitanje invalida rata i svih ostalih pitanja koja su u vezi sa tim, ono koje je izuzetno i koje je predstavljano kao jednim od temelja buduće Vlade, ono se postavlja u jednu vrlo neugodnu poziciju za funkcioniranje tako što će ga rukovoditi predstavnik iz manjinske zajednice a celokupan staf, odnosno osoblje koje će menažirati biće iz koalicije nasledjenih iz prethodnih mandata. Dakle, na startu problemi vezani za funkcioniranje svih ministarstava koje sam spomenuo.

I jedna nedoslednost, koja je vrlo važna, vezano za druge zajednice – Bošnjake, Rome, Egipćane i tako dalje, takodje je došlo do jedne promjene s obzirom da je to tradicionalno Ministarstvo koje je dalo tim zajednicama resor zdravstva, sada je u pitanju novi resor, ambijent, okolina, zaštita okoline, čišćenje, neki već podsmešljivo ovu zajednicu nazivaju čistačima i tako dalje. Dakle, trebalo je objasniti zašto je došlo do ovih promjena i ovde ja bih dozvolio sebi da se odvažim i da direktno pitam gospodina Thačija – mislim da način donošenja odluke za Ministarstvo za ambijent i okolinu i dodeljivanje ovog ministarstva nije bio adekvatan, nije bio odgovarajući, bio je jako užurban, radjeno je u

zatvorenom krugu kao što se inače radilo i o mnogim drugim pitanjima i mislim da je trebalo da se uradi mnogo poštenije, transparentnije i da druge zajednice na ovaj način dobijaju konačan osjećaj da se ravnopravne a ne da su druge, da su zapostavljene, da su diskriminirane ili bilo kako. Radjeno je po principu – uzmi ili ostavi, eto to je ministarstvo koje je ostalo. Uopšte nisu konsultovani IRDK, PDAK, SDA i GIG. Dakle, najmanje 7 poslanika odnosno polovina poslanika iz drugih zajednica ili nije konsultovano, ili su zapostavljeni u tom konsultovanju. Dakle, na startu je učinjena jedna nepravda.

S obzirom da jedan od temelja Vlade, buduće Vlade, počiva na proklamovanoj ravnopravnosti, a da se Kosovo predstavlja kao zemlja jednakih mogućnosti – na startu ovaj čin je obeshrabrujući za druge zajednice i za one koji sebe smatraju da su oštećene na ovaj način.

I na kraju da kažem, naravno, da je svima nama stalo da ova Vlada bude uspešna, da ova Vlada riješi mnoge važne probleme. Svima nama je veoma stalo da u okviru ove Vlade rešavamo ne samo status Kosova, nego i status Bošnjaka, Roma, Egipćana, Haškalija, Srba. Dakle, status svih građana u njemu. A da bi smo to riješili, ti građani ne trebaju biti samo na riječima ravnopravni, nego trebaju biti i u stvarnosti.

Dakle, gospodine mandataru, trebate dokazati da ste u stanju da poštujete sve zajednice, sve poslanike i da se dogovori koji se tiču svih nas trebaju voditi na samo jedan mogući način: razgovaranjem i dogovoaranjem, a ne imponovanjem. Hvala vam lijepa!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Riza Smaka, le të përgatitet diskutanja e fundit Besa Gaxherri.

RIZA SMAKA: I nderuari Kryetar i Kuvendit të Kosovës,
I nderuari Kryetar i Kosovës,
I nderuari mandatar për kryetar të Qeverisë së Kosovës,
Fillimisht potencoj faktin se unë, si një nga deputetët e këtij Kuvendi, kam konsiderata të larta për koalicionin e dy partive politike, të cilat e kanë bërë dhe jam i bindur se këto dy parti politike, si parti që kanë dhënë shumë kontribut për çështjen e Kosovës, do të bëjnë punë të mëdha, natyrisht duke llogaritur krejtësisht edhe në përkrahjen tonë bona fidej. Natyrisht, herë pas here, qortimet tona do të jenë qëllimmira, jo kritikë për kritikë, por do të thotë në atë synimin më sublim. Ju lutem, kam kënaqësi t'ju uroj zgjedhjen për Kryetar të Kuvendit, të Kosovës dhe zotit Thaçi, pasi të zgjedhet, po asisoj - urimet më të përzemërta.

Do të kisha poentuar vetëm një çështje, e cila në ekspozenë e zotit Thaçi nuk u tha. Ju lutem, shteti ligjor është aspirata më sublime e çdo qytetari. Shteti ligjor nuk mund të bëhet ndryshe pa e pasur një rend juridik modern. Rendi juridik i Kosovës është tepër problematik. Rendi juridik i Kosovës është tepër i komplikuar. Rendi juridik i Kosovës konsiston nga disa formacione të akteve juridike të përgjithshme të miratuara në periudha të caktuara të ndryshme, inkohente, nga ekspertë të ndryshëm, nga politika juridike dhe kultura juridike të ndryshme. Ka shumë kontradikta në rendin juridik të Kosovës, ka

shumë vakume juridike. Edhe juristët më të spikatur vështirë do të kishin për t'u gjetur në interpretimin dhe në aplikimin adekuat të dispozitave juridike valide sot në Kosovë.

Angazhohem që të inkorporohet në programin e Qeverisë së Kosovës, bërja e kodeve – kodifikimi i së drejtës. Ne kemi ekspertë të shkëlqyeshëm, mund të angazhojmë edhe ekspertë të tjerë. Kjo punë mund të bëhet shumë lehtë sepse njihet kodi prej Hamurabit 8 shekuj para epokës së re, edhe e Justinianit, edhe e Likurgut edhe më herët, edhe i Napoleonit. Ju lutem, këto punë nuk janë të vështira, këto janë të lehta, vetëm duhet organizimi, ekziston vullneti dhe nevoja imediate, duhet të bëhet, ju lutem.

Do të isha angazhuar, ju lutem që të mendojmë qysh tash për modalitetin e pavarësisë politike të Kosovës. Ne e kemi eksploatuar. Kemi miratuar Deklaratën për Pavarësinë e Kosovës, kemi miratuar Kushtetutën e Republikës së Kosovës në Kaçanik, kemi mbajtur Referendumin për Pavarësinë e Kosovës, kemi bërë luftë politike-diplomatike dhe luftë me, si thuhet në popull, grykëhollën, apo jo, të gjitha. Ju lutem, statusi politik, nuk përcaktohet as me deklaratë, as me rezolutë, aq më parë kur e kemi një dokument juridik ndërkombëtar valid aplikativ, që quhet Rezolutë e Këshillit të Sigurimit dhe çdo dokument juridik ndërkombëtar apriori e ka pozicionin në hierarkinë mbi dokumentet juridike adekuate të shteteve, aq më parë, ne nuk jemi shtet për momentin, apo jo...

KRYETARI: Zoti deputet, i përmbaheni rendit të ditës!

RIZA SMAKA: ...Ju lutem, angazhohem, që të meditojmë për aplikimin e plebishitit, i cili është instrument, metodë dhe mekanizëm për vetëvendosjen politike të popullit, ka mbështetje në dokumentet juridike ndërkombëtare dhe me të përcaktohet statusi politik i një vendi, në këtë rast i Kosovës. Faleminderit shumë!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Besa Gaxherri dhe, shpresoj i fundit, Slobodan Petrović.

BESA GAXHERRI: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit,
Kryetar i Kosovës,
Zonja Kajdanov,
Zoti Ruecker,
Zoti Jonsson,
Zoti mandatar për Qeverinë, që po presim ta votojmë sot,

Zoti mandatar i Qeverisë së ardhshme të Kosovës, neve sot na hapet rrugë për të folur më shumë për koalicionin, për “martesën” tuaj shumë të panatyrshme sesa për të diskutuar për një program të cilin e presin qytetarët e Kosovës, për ekspozenë me të cilën në vija shumë të trasha iu drejtove qytetarëve të Kosovës, e që, në të vërtetë, nuk pati asgjë në të.

Megjithatë, gjatë fushatës ju keni premtuar programe shumë të mëdha dhe uroj që t'i realizoni ato. Diçka që më bëri përshtypje sot, në atë anën negative, kisha për të thënë – është se tash ne jemi në pikën e rendit të ditës për zgjedhjen e Qeverisë, sepse sot, edhe pse deputetët pa rend të ditës hynë në këtë seancë, jemi pra në pikën e rendit të ditës për zgjedhjen e mandatarit dhe të Qeverisë. Dhe, asnjëri prej të parazgjedhurve, si Kryetari i

Kuvendit dhe Kryetari i Kosovës, nuk qenë në gjendje të thonë se do të kemi bashkëpunim me opozitën e Kuvendit të Kosovës. Së paku ju, zoti mandatar, që e keni provuar për një mandat të jeni opozitë, nuk kërkon bashkëpunim me opozitë sepse e keni bërë një “martesë” të fuqishme – për hair ju qoftë! E keni bërë ju personat, dua të them se nuk e keni bërë në emër të elektoratit, as të qytetarëve të Kosovës. Qytetarët e Kosovës kanë votuar për ndryshime, ndërsa ju keni bërë pazare. Megjithatë, do të shkojmë tutje.

Unë sot ju them se Lidhja Demokratike e Dardanisë është opozitë, por do të jetë shumë konstruktive dhe shumë parimore në çështjet nacionale. Natyrisht, edhe në qoftë se juve ju duket e papeshë dhe e vogël, do të jetë opozitë e fuqishme. Sepse, të nderuar, keni parasysht, as 40% të qytetarëve të Kosovës, nuk kanë dalë në zgjedhje dhe prej 40% që kanë dalë jemi ne sot sa jemi këtu. Dhe, natyrisht, edhe atyre 40% që kanë dalë në zgjedhje iu ka shkelur vullneti i tyre, iu ka shkelur vota për çka kanë votuar, andaj ne do të jemi vërtetë një opozitë e fuqishme. Do t’ju mbështesim, aty ku kërkohet, dhe do të kundërshtojmë, aty ku do të kemi të drejtë. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka Slobodan Petrović, i fundit, shpresoj.

SLOBODAN PETROVIĆ: Uvaženi predsedniče Skupštine,
Poštovani predsedniče Kosova,
Gospodine Ruecker,
Gospodja Kajdanov,
Uvaženi mandataru,
Dame i gospodo narodni poslanici,
Poseban pozdrav za medije, jer mi možemo da pričamo ovde sve i svašta, a bitno je šta oni prenesu.

Dozvolite mi, pre svega, da kažem da sam ovde ispred Poslaničkog kluba Samostalne liberalne stranke, koji čine četiri stranke. Znači, pored Samostalne liberalne stranke, Nova demokratija, Savez nezavisnih demokrata, i ono, što je posebno nama drago, jeste i pripadnik druge zajednice, znači Goranske zajednice – predsednik Gradjanske odnosno i poslanik ujedno Gradjanske inicijative Gore.

Čuli ste u ekspozeu mandataru budućeg premijera da u budućoj Vladi biće i dva ministra koji su iz Srpske zajednice. Nama je ukazana velika privilegija i velika čast da imamo dva kandidata, odnosno dva ministra i, s druge strane, jedna velika odgovornost.

Mi, kao odgovorni ljudi, kao pripadnici Srpske zajednice smo ovde, pre svega, da štitimo interese Srpske zajednice, svakako – ne na štetu Albanske zajednice, niti bilo koje druge zajednice. Samim tim, pošto je i član našeg kluba, pripadnik Goranske zajednice, i ne samo zbog toga, mi smo spremni da budemo na pomoći svim onim ljudima, svim gradjanima Kosova. Pre svega, sam čin izlaska na izbore i ulaska u Parlament, dovoljno govori za naše namere i naše ambicije. Naš jedini, i najbitniji motiv, jeste da svi oni ljudi, svi gradjani Kosova koji su, bez obzira na naciju i veru, imali puno problema, i dan danas imaju. Znači, naš cilj i naša obaveza je da stanemo iza tih ljudi kako bi im bilo bolje sutra.

Ono što je u ekspezu mandataru bilo, u principu sve je ono što i u našem programu stranke. Ali imam obavezu, ispred Poslaničkog kluba, ispred ljudi koji će biti u Vladi - da kažem, i da sam svestan da i vi sami ne očekujete da će pripadnici Srpske zajednice da se zalažu, ne znam – za nezavisno Kosovo. To, samim tim, ne dovodi u pitanje vaše zalaganje.

Naš stav je potpuno jasan od samog početka. Mi želimo da se status Kosova reši što pre, da se reši u interesu svih ljudi koji žive ovde, bez obzira na nacionalnu pripadnost.

Vi znate da je veliki problem bilo učešće na ovim izborima. Pričam za Srpsku zajednicu i da imamo dodatni problem. Mi smo svesni činjenice da većina građana Srpske nacionalnosti je bila protiv ovih izbora. Ono što je još dodatno opterećavajuća okolnost jeste da je državni vrh Republike Srbije bio protiv ovih izbora.

Sve to po strani. Naš slogan za ove izbore je bio – svoj život u svoje ruke. Mi želimo svojom glavom da razmišljamo za nas, naše porodice, naše zajednice i sve građane Kosova.

Ono što očekujemo od Vlade, od predsednika Kosova, od Skupštine, od međunarodne zajednice da nedvosmisleno da podršku ljudima koji će biti u Vladi, ljudima koji su iz manjinske zajednice. Mi možemo da sedimo krivo ali moramo pravo da zborimo. Znači mi, realno govoreći, u svojoj zajednici, pričam za sve pripadnike Srpske zajednice koji su u Parlamentu, a tu ima deset poslanika, nismo dobili većinske glasove, ali sam ubedjen da smo izabrali pravi put. Ovi ljudi koji će biti u Parlamentu i koji će štititi srpske interese, odnosno interese Srpske zajednice, apsolutno želim da vas uverim da je to interes i Albanske zajednice.

Jedan mudar čovek je rekao: „Teško onom ko svoje prijatelje traži u tuđini, odnosno svoje neprijatelje u blizini“. Ja, u ovom Parlamentu, ne vidim neprijatelje. Možemo da budemo politički protivnici. U svakom slučaju, Poslanički klub Samostalne liberalne stranke želi ovoj Vladi dobro, želi građanima Kosova dobro i Poslanički klub Samostalne liberalne stranke će podržati ovu Vladu, i Poslanički klub Samostalne liberalne stranke odnosno dva ministra koji će biti iz tog Poslaničkog kluba će dati svoj maksimum u interesu, pre svega onoga za šta smo postavljeni, u interesu što boljeg prosperiteta Srpske zajednice, opstanka Srpske zajednice, zapošljavanja, i opet kažem, ne na štetu nijedne druge zajednice.

Još jednom, dozvolite mi da čestitam svima onima koji su izabrani. Gospodine predsedniče, čestitam na izboru. Gospodine Skupštine i vama. Predsedništvu Skupštine čestitaću kada bude kompletno, jer fali još jedan, to je znači pripadnik Srpske zajednice. Gospodine mandataru, želim vam puno sreće, puno uspeha. Vaš uspeh je i naš uspeh! Hvala!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit! Tani fjalën e ka kërkuar Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ: I nderuari, zoti Kryetar i Kuvendit,
I nderuari zoti Kryetar i Kosovës,
Mandatar i ardhshëm, zoti Thaçi,
Zonja Kajdanov,
Zoti Ruecker dhe përfaqësues deputetë,
Dola këtu që t'ju përshëndes dhe t'i dëshiroj Qeverisë së ardhshme suksese, për arsye se sukseset e Qeverisë do të jenë edhe suksese të të gjithë qytetarëve.

Mirëpo, dola këtu që të them diçka për disa ministri, sikur është Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit, sepse doli këtu një i komunitetit serb dhe tha se do të jetë kryesisht dhe kryekëput e angazhuar rreth komunitetit serb. Unë shpresoj se Ministria e Komuniteteve dhe e Kthimit nuk do të jetë vetëm e komunitetit serb, por do të jetë e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë. Bile, komunitetet joserbe, janë të lëna shumë pas dore dhe këtë e kam kritikuar, edhe pse kam qenë pjesë e Qeverisë. Po them që ministri për komunitete dhe kthime shpeshherë do të jetë pranë këtij Parlamenti dhe do të japë llogari për çdo cent para qytetarëve dhe para të gjitha bashkësive etnike që jetojnë në Kosovë, sepse buxheti dhe tatimpaguesit janë edhe të komunitetit egjiptas, të komunitetit rom dhe të atij turk dhe dëshirojmë që të kërkojmë llogari edhe nga ajo Ministri për Komunitete dhe Kthim.

Prandaj, zoti Thaçi, si mandatar i ri, do të jetë një detyrë shumë – shumë e rëndësishme në integrimin e të gjitha komuniteteve. Këtu nuk po më pëlqen fjalori i disa individëve qoftë vendorë, qoftë ndërkombëtarë që thonë “veçanërisht komuniteti serb”. Nuk di, duhet t'i keni parasysh edhe komunitetet e tjera. Nuk jemi të integruar në institucione ashtu siç duhet. Nuk jemi të përfaqësuar në ndërmarrje publike. Nuk jemi të përfaqësuar në shumë – shumë institucione me rëndësi. Nuk duhet të kërkohej vetëm nga komuniteti serb, sepse edhe komunitetet e tjera kanë vepruar, do të veprojnë në të mirën e Kosovës, kanë pranuar realitetin e Kosovës, për arsye se në këtë histori kemi ecur bashkërisht e këtë e them edhe për komunitetin egjiptas, që ka edhe dëshmorë të luftës dhe do të kontribuojë edhe në të ardhmen. Mirëpo, nuk më duket mirë që të ndahen ministrinë që nëse udhëheq një nga komuniteti im të derdhen të gjitha mjetet për komunitetin egjiptas, ose të udhëheqet nga komuniteti serb dhe të harxhohen të gjitha mjetet për komunitetin serb. Edhe ndarja e drejtë buxhetore, që është bërë nëpër komuna, është bërë mbi 90% vetëm për komunitetin serb. Këtu, në Kosovë, duhet të ndahen mjetet për të gjithë në mënyrë të barabartë. Kur them kështu, them se mbi 90% të komunitetit egjiptas, rom, turq dhe komunitete të tjera – jetojnë në varfëri të skajshme, prandaj do të jetë prioritet i kësaj Qeverie që t'i realizojë edhe të drejtat e të gjitha komuniteteve.

Nëse këtë e arrini dhe i realizoni të drejtat e komuniteteve, atëherë do të jeni edhe mandatar i suksesshëm. Unë besoj se do t'ia arrini. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti Neziraj! Unë kisha dashur që t'i njoftoj deputetët se për programin e Qeverisë do të debatohet atëherë kur Kryeministri ta sjellë për debat

programin e Qeverisë dhe ftoj deputetët të cilët e marrin fjalën të përqendrohen në rendin e ditës. Fjalën e ka zoti Driton Tali.

DRITON TALI: Zoti Kryetar,

Zoti President,

Zoti mandatar Thaçi,

Mister Ruecker,

Zonja Kajdanov,

Zotit mandatar desha t'ia bëj një pyetje për shkak se një nga slloganët e tij ka qenë: “Me duar të pastërta” dhe po ashtu ka premtuar se kandidatët e propozuar do të shkojnë nëpërmjet një procesi të qartësimit ose të klarifikimit të së kaluarës së tyre. Nuk flas vetëm për atë se e kanë shijen e sotifikuar në verëra që shpenzonin shuma të mëdha, por edhe për disa kandidatë të cilët ua dëgjuam emrin këtu e që kanë qenë goxha të përfolur nëpër media dhe çfarë kanë qenë certifikatat e lëshuara nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Drejtësisë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ky ishte deputeti i fundit i lajmëruar për debat. I nominuari për Kryeministër, zoti Thaçi, na njoftoi për ministrat, por jo edhe për zëvendësministrat. Unë nuk do ta mundoja të nominuarin që t'i lexoj, por po i lexoj emrat e zëvendësministrave.

(Reagime)

Unë vetëm desha t'ia lehtësoj pak dhe të procedojmë më tutje. Urdhëroni, e keni fjalën. Tash për tash nuk ka të paralajmëruar për fjalë. Tani duhet të lexohen emrat e zëvendësministrave. Listën e kemi ne.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Faleminderit, edhe një herë, zoti Kryetar!

- Për zëvendësministër të Transportit dhe Telekomunikacionit, është propozuar Adem Grabovci;
- Për zëvendësministër të Ekonomisë dhe Financave Bedri Hamza;
- Për zëvendësministër për Ministrinë e Energjetikës dhe Minierave prof. dr. Blerim Rexha;
- Për zëvendësministër të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë është propozuar prof. dr. Agim Hyseni;
- Për zëvendësministër të Drejtësisë është propozuar zoti Arsim Janova;
- Për zëvendësministër të Shërbimeve Publike, prof. dr. Rifat Blakaj;
- Për zëvendësministre të Shëndetësisë, dr. Mubera Mustafa;
- Për zëvendësministër të Punëve të Brendshme dr. Fatmir Xhelili;
- Për zëvendësministër të Bujqësisë, prof. dr. Sylë Sylanaj;
- Për zëvendësministër për Tregti dhe Industri, Naser Osmani;
- Për zëvendësministër për Pushtet Lokal, zoti Shpend Terdeva;
- Për zëvendësministre për Kulturë, Rini dhe Sporte, zonja Lirije Kajtazi;

- Për zëvendësministra, që iu takojnë komuniteteve, kanë mbetur edhe disa konsulta në raport me partitë minoritare dhe shpresoj se do të keni mirëkuptim, sepse nevojitet një qartësim nga spektri minoritar;
 - Për zëvendësministër të Mirëqenies Sociale, Gjergj Dedaj.
- Faleminderit!

KRYTARI: Të nderuar deputetë, në sallë kemi të pranishëm 112 deputetë nga 120 sa i ka Kuvendi i Kosovës.

Tani, votimin do ta bëjmë për Kryeministër dhe për zëvendës-kryeministrat, ministrat dhe zëvendësministrat me një votë formale.

Kush është “për”? Lus Sekretarinë t’i numërojë votat.
Faleminderit!

A ka kush “kundër”?
A abstencion ndokush?

“Për” janë 85 deputetë, “kundër” 22, kurse kanë abstenuar 4.

Konstatoj se Kuvendi i Kosovës, sot, më 9 janar 2008, zgjodhi Kryeministrin dhe gjithë Kabinetin e Qeverisë së Kosovës.

Kryeministrin, zëvendëskryeministrave, ministrave dhe zëvendësministrave iu dëshirojmë fat dhe sukses.

(Duartrokitje)

Lus që Kryeministri, zëvendëskryeministrat dhe ministrat t’i zënë vendet e tyre. Zëvendësministrat mbesin në vendet e tyre dhe gjatë leximit të betimit ata rrinë në këmbë. Tekstin e betimit e lexon Kryeministri i porsazgjedhur, zoti Hashim Thaçi. Urdhëroni, zoti Thaçi!

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI:

“Ne, anëtarët e Qeverisë së Kosovës, të zgjedhur nga Kuvendi i Kosovës, betohemi solemnisht se me përgjegjësi, me përkushtim dhe me ndershmëri do t’i kryejmë të gjitha detyrat dhe punët që i kemi sipas mandatit të dhënë nga ky Kuvend, gjithmonë duke zbatuar ligjin dhe vendimet e miratuara, duke respektuar parimet, normat dhe standardet ndërkombëtare për liri, barazi, demokraci, në interes të përparimit ekonomik, arsimor, kulturor e të gjithmbarshëm të popullit dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës. Betohemi”!

Kabineti qeveritar: B e t o h e m i!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Zoti Kryeministër, urime juve dhe të gjithë zëvendësministrave, ministrave dhe zëvendësministrave. Fjalën përshëndetëse dhe falënderuese e ka Kryeministri i Kosovës, zotëri Hashim Thaçi.

KRYEMINISTRI HASHIM THAÇI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!
Është hera e dytë, që në jetën time më besohet nga uniteti politik dhe legjitimiteti qytetar përgjegjësia për të qenë Kryeministër i Kosovës dhe të udhëheq Qeverinë e Kosovës.

Ju faleminderit për mbështetje, për përkrahje! Faleminderit dhe respekt!

Të nderuar deputetë,
Zotohem se do të punoj me të gjithë, për të gjithë, për të mirën e vendit dhe të të gjithë qytetarëve të Kosovës.

Më lejoni që përsëri t'ju falënderoj për besimin që keni tek unë.
Sot përgjegjësia ime është e madhe, është e dyfishtë, është përgjegjësi që me besohet edhe nga njerëzit legjitim, të votuar nga qytetarët e Kosovës. Është përgjegjësi e dyfishtë, sepse më është besuar për të udhëhequr Qeverinë e Kosovës nga shumica absolute e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, nga koalicioni ynë, nga opozita demokratike, nga i gjithë spektri politik minoritar dhe unë zotohem se do të punoj për të mirën e të gjithëve, me të gjithë ju do të jem partner dhe do të ndërtojmë Kosovën demokratike dhe shumetnike.

Unë jam i sigurt se çdo qytetar i Kosovës e ka në shpirt një ëndërr që ka të bëjë me mundësinë për të bërë ndryshime pozitive për vendin, për qytetarët dhe për ardhmërinë e tyre.

Ju sot më dhatë një përgjegjësi, por dhe nder shumë të madh, dhe unë ju falënderoj shumë për këtë.

Derisa po flas sot këtu, ashtu sikur edhe ju, në mendje më vijnë, na vijnë shumë heronj, martirë dhe atdhetarë të kombit tonë. Heronjtë e rezistencës civile dhe heronjtë e luftës së fundit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në krye me komandantin legjendar Adem Jashari, të cilët për gjithmonë do të jenë të respektuar nga institucionet dhe populli i Kosovës.

Kështu, përderisa ne në këtë vend, Kuvend vazhdojmë punën që ata e kanë filluar, ne duhet të kujdesemi që gjithmonë të udhëhiqemi nga forcat e tyre, besimi i tyre dhe vlerat e tyre.

Përshëndetje, President Sejdiu! Unë pres që të bashkëpunoj ngushtë me Ju, në mandatin tonë 4- 5 vjeçar, në periudhën kritike që do ta ketë kjo Qeveri në përpjekjet e saj për të vënë Kosovën në epokën e re të lirisë, të pavarësisë, të zhvillimit dhe të rendit demokratik.

Përshëndetje, Kryeministër Çeku! Ju falënderoj për shërbimin dhe miqësinë që e keni treguar.

Të nderuar kolegë, deputetë,

Përshëndetje ish kryeparlamentarit, zotit Kolë Berisha! Respekt dhe mirënjohje për punën tënde që ke treguar në të udhëhequrit e mëparshëm të Parlamentit të Kosovës.

Të nderuar kolegë, edhe sot qytetarëve dhe popullit tim ia jap fjalën se do të punoj çdo ditë dhe në çdo mënyrë demokratike që të bëjmë që të ndihen krenar me vendin qytetarët tanë, që secili nga ne të ndihet mirë për të jetuar në Kosovë.

Sfidat për të cilat jemi zotuar se do t'i tejkalojmë, nuk janë të pamundura, nëse ne do të ballafaqohemi me to me forcë dhe me unitet. Unë sot si kryeministër i sapozgjedhur nga ju, nga populli i Kosovës, nuk jam të përshkruaj gjendjen e rëndë në të cilën gjendet Kosova dhe populli i Kosovës, por jam që të ofroj alternativat më të mira për ndryshime dhe unë jam i bindur që alternativat më të mira të mundshme për realitetin aktual do t'i prezantojmë dhe do të ecim bashkërisht përpara.

Unë besoj në forcën tonë, besoj në unitetin politik dhe në të gjithë qytetarët kosovarë, sepse është forca, është uniteti, shpresa, besimi dhe mundësia ajo për të cilën ekziston Qeveria. Qeveria e Kosovës do të jetë vetëm e vetëm në shërbim të vendit dhe të të gjithë qytetarëve.

Qeveria e re Kosovës nuk do të jetë partiake, nuk do të jetë e koalicionit, do të jetë Qeveri e Kosovës, do të jetë Qeveri e reformave, do të jetë Qeveri e reformave, do të jetë Qeveri e vullnetit të qytetarëve të Kosovës dhe e përgjegjësive sonë të përbashkët. Por, në të njëjtën kohë unë nuk kam harruar dhe rizotohem para jush dhe të gjithë qytetarëve të Kosovës e partnerëve tanë ndërkombëtar, miqve tanë ndërkombëtar, se do të vazhdoj me këmbëngulësinë më të madhe për ndryshime, dhe ndryshimet për Kosovën fillojnë tani menjëherë.

Ndodhemi në një moment unik. Unë besoj fuqishëm në kredibilitetin e lartë të ministrave që do t'i udhëheqin ministrinë, në kredibilitetin e tyre moral, në aftësinë e tyre profesionale dhe përgjegjësinë e tyre politike, kombëtare e qytetare.

Falënderoj partnerët e koalicionit dhe në të njëjtën kohë Partinë Demokratike të Kosovës për mundësinë dhe mbështetjen e plotë që na kanë dhënë që t'i kemi këta njerëz, burra dhe gra të udhëheqin vendin në mandatin e ardhshëm me besnikëri të plotë, me përgjegjësi të lartë dhe bashkëpunim të ngushtë.

Ndodhemi në një moment historik, në një moment në të cilin ne si Qeveri dhe institucionet e Kosovës do të mund të bëjmë gjëra të jashtëzakonshme për të filluar për të bërë gjëra të jashtëzakonshme. Nuk kemi premtuar dhe nuk premtojmë mrekulli, por jam i bindur se me këtë ekip qeveritar, me mbështetjen tuaj, me partneritetin e ngushtë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me Bashkimin

Evropian dhe autoritet tjera civile në Kosovë e me NATO-n, do të mund t'i bëjmë gjërat më të mira të mundshme.

Kosova po ecën suksesshëm në rrugën e saj. Unë kam besim se ne do të jemi të suksesshëm dhe kam besim të plotë se e ardhmja e Kosovës është e ndritur, se unë e di burimin e forcës që e kemi, e njoh atë forcë, e respektoj dhe jam pjesë udhëheqëse e asaj force. Ky burim nuk qëndron vetëm tek Qeveria. Burimi i vërtetë i forcës sonë qëndron tek fuqia e popullit tonë, që na ka besuar neve të jemi në Parlamentin e Kosovës dhe t'i udhëheqim institucionet e Kosovës.

Populli ynë në të kaluarën bashkërisht, unik, ka tejkalluar sfida të jashtëzakonshme, të mëdha. Tradita dhe mënyra e tij e jetesës ka dëshmuar se beson në ardhmëri dhe mundësi të reja, për çka ka sakrifikuar vazhdimisht për të ardhur në këto ditë të lirisë, në prag të pavarësisht, në ecje të zhvillimit ekonomik dhe në ecje të angazhimeve të sigurta për integrim të Kosovës në strukturat Evro-atlantike, në ato të Bashkimit Evropian, në NATO dhe për raporte të shkëlqyeshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Prandaj, faleminderit Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bashkimit Evropian, NATO-s, autoriteteve civile ndërkombëtare, UNMIK-ut dhe NATO-s.

Me këto vlera, populli ynë gjithmonë do të jetë forca jonë. Pavarësisht se çfarë sfidash do të vijin, unë e di se ne të bashkuar jemi të fuqishëm për t'i tejkalluar ato. Jam i sigurt se nuk ka sfida që ne të bashkuar nuk do të mund ta tejkalojmë dhe jam i sigurt se do t'ia dalim.

Tani dua që për një moment t'i drejtohem drejtpërdrejt sovranit, qytetarëve të Kosovës. Unë i falënderoj përsëri për përkrahjen dhe ua bëjë të ditur publikisht se unë jam i përkushtuar që të lëvizim nga pika ku jemi sot drejt së ardhmes së mbushur me shpresë, mundësi, liri, pavarësi dhe rend demokratik.

Zotimi im për ju është se do të punoj shumë për çdo ditë në mënyrë që ju të jeni krenar për Qeverinë, për vendin tuaj dhe për të gjitha institucionet e Kosovës. Ne kemi përzgjedhur dhe kemi sjellë këtu njerëzit prej më të shquarve që do ta qeverisin vendin tonë. Unë kërkoj nga ata që me nder dhe përkushtim të lartë etik të punojnë për vendin tonë, që të ecim krah për krah drejt së ardhmes më të mirë për vendin dhe për gjithë qytetarët e Kosovës.

Ju që jeni të pranishëm në Kuvend, deputetë të nderuar, ministra të nderuar, Deputetë të nderuar, me votën tuaj për këtë Qeveri i keni dërguar mesazh të qartë atyre që i përfaqësoni, popullit të Kosovës.

Qytetarët e Kosovës kanë votuar për një Qeveri të fortë, të vendosur me adresë politike e përgjegjësi e legjitimitet qytetar dhe kjo Qeveri është afruar, është votuar dhe faleminderit nga të gjithë ju.

Kjo Qeveri do të ecën përpara e bashkuar dhe do të sjellë ndryshime të domosdoshme të cilat i kanë kërkuar dhe i presin qytetarët tanë. Ju faleminderit për këtë nder të madh.

I falënderoj anëtarët e Qeverisë së Kosovës dhe me përgjegjësi të lartë zotohem se do të jem kryeministër i gjithë qytetarëve të Kosovës, pa dallime etnike. Tani kemi Qeveri të fortë, të fuqishme dhe shumetnike.

Më lejoni që t'u drejtohem edhe në gjuhën e komuniteteve të pranishmëve në sallë.

Dame i gospodo,
Poštovani poslanici,
Uvaženi gosti,

Moja Vlada kao jedno od prioriteta imaće vladovinu prava sa posebnom pažnjom prema pravima manjina. U okviru ove politike mi ćemo dati sve od sebe da stvorimo klimu tolerancije u odnosima sa manjinama, naročito sa Srpskom zajednicom. Mi ćemo raditi na tome da Kosovo bude mesto gde će se svi građani osećati ravnopravnim i sigurnim. Mi ćemo se zalagati za povratak svih koji su napustili Kosovo. I oni su deo Kosova i biće dobrodošli.

Kosova je otadžbina svih njenih građana. Ja ću biti premijer svih građana Kosova.

Dhe tani, të nderuar deputetë,

E ritheksoj përkushtimin tim për të ecur përpara në rrugën tonë të përbashkët. Unë i kam marrë përgjegjësitë të cilat edhe i kam premtuar dhe, natyrisht, në këto përkushtime specifike dhe shtesë do të jenë edhe hapja e zyrave pranë Zyrës së Kryeministrit për Veteranët dhe Shoqatat e Luftës dhe do të jem vetë i involvuar në zgjidhjen e problemeve të tyre. të Zyrës për Komunitetin e Biznesit që e vlerësoj dhe do të jetë partner i Qeverisë së Kosovës për të mirën e tyre, për lehtësira në angazhimet e biznesit, të Zyrës për Komunitete, të Zyrës për Komunitetin e Pensionistëve, për Energji, për Transport dhe për Diasporë.

Sot, të nderuar të pranishëm, deputetë të nderuar, kemi prezantuar, unë si Kryeministër dhe Kabineti Qeveritar, ekspozenë programore të Qeverisë së Kosovës në vija të trasha. Ju faleminderit të gjithëve për përkrahje fillimisht, për rekomandimet që do të jenë të respektuara nga ana ime për të inkorporuar në programin qeveritar dhe në projektet e mia, për vërejtjet dhe sugjerimet që keni prezantuar, që për mua janë të rëndësishme. Institucionet e Kosovës do të funksionojnë në tërë territorin e Kosovës, në bashkëpunim me komunitetin ndërkombëtar. Për Kosovën nuk do të ketë aneksim, do të ketë vetëm integrim.

Unë do të ndërtoj apo do të vazhdoj t'i ruaj dhe t'i kultivoj raportet e fqinjësisë së mirë Kosovës edhe me Maqedoninë, edhe me Shqipërinë, edhe me Malin e Zi, dhe në të ardhmen demokratike edhe me Serbinë, si dy vende të veçanta.

U ngritën edhe çështje nga ato të vlerësuara shumë nga ana ime për aktualitetin në të cilin ndodhet Kosova dhe për orientimet programore, por edhe për zhvillimet politike. Ritheksoj, nuk do t'ju lodh që të përshkruaj gjendjen e rëndë në të cilën kjo Qeveri e merr Kosovën për ta udhëhequr, gjendjen e rëndë në të cilën gjendet populli i Kosovës. Kjo Qeveri ka marrë zotimet për të filluar për të përmirësuar jetën e tyre. Të gjithë i dini, të gjithë i dimë, ju ftoj të gjithëve të bashkuar të fillojmë të ecim përpara dhe t'i fillojmë këto ndryshime.

Jam i bindur se kemi potencial të fuqishëm politik dhe për të mirën e Kosovës, të vendit dhe të të gjithë qytetarëve nuk duhet të ketë dallime partiake. Do ta kultivojmë demokracinë në Parlament dhe në Kosovë. Kosova po krijon traditën e vet demokratike të raporteve pozitive – opozitive.

Ju faleminderit për angazhimet që keni treguar edhe si opozitë me diskutimet tuaja. Unë dua vetëm të falënderoj publikisht për përkrahjen e plotë e të fuqishme që këtë Qeveri e bën edhe më të përgjegjshme dhe kredibile, për përkrahjen nga kryetari i AKR-së zoti Behgjet Pacolli. Unë e ritheksoj, ne do të jemi partner për të mirën e Kosovës, për të mirën e të gjithë qytetarëve të Kosovës. Por, në të njëjtën kohë e di se vota e opozitës për mua është përgjegjësi e re, është përgjegjësi shtesë dhe do të punojmë me të gjithë ju si partner në të gjitha projektet që ndërlidhen me interesat e vendit.

Opozita, dua t'ju them se pak kush nga ju në Parlament e ka përjetuar në lëkurën e vet sa unë opozitën. Por, në të njëjtën kohë, më vjen shumë mirë që e kemi ruajtur dhe kultivuar gjithmonë unitetin shtetformues dhe kemi funksionuar shkëlqyeshëm si Ekipi i Unitetit, pozitive dhe opozitive dhe unë dua të besoj se do të ecim bashkërisht përpara. Është e vërtetë se nganjëherë më ka kritikuar edhe partia pse kam shpall njëfarë moratoriumi të heshtur në raport opozitar me Qeveri më herët, por sido që të jetë, e di se gjithçka është bërë për të mirën e vendit dhe të qytetarëve dhe jam i bindur se ka qenë e drejtë, më ka dhënë të drejtë koha, realiteti dhe vetë populli i Kosovës dhe miqtë ndërkombëtarë.

Dhe, të jeni të sigurt, të nderuar kolegë opozitarë. Do të jem avokat i juaj çdo herë kur keni të drejtë, se ju kuptoj, por në të njëjtën kohë edhe do të jem ballafaques pozitiv i argumenteve.

Dhe, tash, nuk na mbetet gjë tjetër, vetëm t'i përvishemi punës që t'i sfidojmë problemet e mëdha që ndodhen para nesh. Ju uroj fat, punë e suksese!

Të nderuar ministra, Qeveri e Kosovës, zoti President, të nderuar deputetë. Faleminderit, mirënjohje, respekt, suksese e drejt punës!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Vazhdojmë punën. I kemi edhe dy fjalë përshëndetëse. Së pari Presidenti i Kosovës dhe pastaj Shefi i UNMIK-ut, zori Ruecker.

JOACHIM RUECKER: Ok if you allow me Mr. President just let me express my sincere congratulations and respect for the forming of the Government for the election of the President. I think this once again has shown how mature Kosovo Institutions are and how ready everybody is to go to the next step. Thank you.

(Duartrokitje)

KRYETARI: Faleminderit, zoti Ruecker! Fjalën e ka Presidenti, zoti Sejdiu.

PRESIDENTI FATMIR SEJDIU: Faleminderit, zoti Kryetar i Kuvendit,
Zoti Kryeministër,
Të nderuar ministra,
I nderuari zoti Ruecker,
Zonja Kajdanov,
Zoti Jonsson,
Mysafirë të pranishëm,
Të nderuar deputetë,

Kjo është një dëshmi e veçantë e funksionimit të mirëfilltë dhe të thellë të demokracisë në Kosovë, bartës të së cilës janë institucionet e Kosovës, mandatar të të cilave janë qytetarët e Kosovës.

Me këtë rast dëshiroj të uroj Kryeministrin Thaçi, Qeverinë në tërësi dhe gjithë ju në pozitë dhe në opozitë për një bashkëpunim të jashtëzakonshëm që është i nevojshëm, që është vazhdimësi e kësaj qasjeje të mirë që ka marrë Kosova në ecjen e saj demokratike për të mbërri qëllimin tonë madhorë. Ju premtoj se do të angazhohem fuqishëm që të jem zë unifikues i të gjithë juve dhe bashkëpunues me institucionet e Kosovës, derë e hapur dhe e përbashkët e punës së përbashkët.

Dëshiroj të falënderoj, po ashtu në veçanti, ndihmën e vazhdueshme që Kosovës i është dhënë, i jepet dhe do t'i jepet nga Bashkësia Ndërkombëtare, nga Bashkimi Evropian, nga shtetet e Bashkuara të Amerikës, nga NATO-ja që ruan paqen e stabilitetin në Kosovë bashkë me qytetarët e Kosovës, sepse stabiliteti është i nevojshëm dhe ne e kemi dëshmuar dhe do të ecim në funksionalizim të plotë të dëshmimit të Kosovës si shtet sovran dhe i pavarur. Urime!

(Duartrokitje)

KRYETARI: Të nderuar deputetë, me kaq po e përfundojmë. Mirë u pafshim në seancat e punës.

Përgatiti:
Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës